

Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit

Udhëzues riintegrimi për profesionistët



Ky Udhëzues Riintegrimi u përgatit nga Instituti NEXUS dhe "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (D&E), në kuadër të projektit: Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të riintegritit dhe përmirësimi i kuadrit të mbrojtjes për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrimi të hartuar për të mbështetur punën e profesionistëve të riintegritit në Shqipëri, si dhe të profesionistëve nga vendet dhe rajonet e tjera.

Autore: Rebecca Surtees
Kontribues: Mariana Meshi, Stela Tanellari, Ana Lila, Ornela Hinaj dhe Burbuqe Meçaj
Faqosja dhe dizajni: Laura S. Johnson
Ilustrim: Viktimat e trafikimit të asistuar nga "Të Ndryshëm & Të Barabartë"

Citimi i sugjeruar: Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari, A. Lila, O. Hinaj and B. Meçaj (2022) *Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegrimi për profesionistët. Tiranë: Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Washington, D.C.: NEXUS Institute.*

© 2022 Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) dhe Instituti NEXUS

Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit, dhe për të ndryshuar kontekstin ligjor, institucional dhe social për të luftuar këto abuzime. Aktivitetet kryesore të D&E përfshijnë: identifikimin dhe referimin e viktimave; ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, afatgjata të riintegritit (rezidenciale dhe komunitare); ndërgjegjësimin e komuniteteve për trafikimin e personave dhe për të drejtat e viktimave të trafikimit; parandalimin e trafikimit nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cënueshme; trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të partnerëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile; studime dhe vlerësime; asistencë teknike në hartimin e ligjeve dhe legjislacionit për mbrojtjen e viktimave të trafikimit; dhe advokimin për të drejtat dhe mbrojtjen për viktimat e trafikimit.




www.differentandequal.org



@DifferentEqual

Instituti NEXUS® është një qendër e pavarur ndërkombëtare për kërkime dhe politika mbi të drejtat e njeriut. NEXUS i dedikohet dhënies fund të formave bashkëkohore të skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe abuzimeve dhe veprave të tjera penale që ndërthurin të drejtat e njeriut dhe politikat e të drejtën penale ndërkombëtare. NEXUS është lider në kërkime, analiza, vlerësime dhe asistencë teknike, dhe në zhvillimin e qasjeve novatore për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe problematika lidhur me të.



Lëre të ik

Ne do ecim përpara së bashku, pa e
kthyer kokën pas....

*Ilustrim dhe citim nga
viktimë e trafikimit e asistuar
nga Të Ndryshëm dhe Të
Barabartë (D&E)*

Tabela e përmbajtjes

Rreth udhëzuesit të riintegrit. Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit.....	1
Çfarë është ky udhëzues	
1	
Audienca e synuar.....	
1	
Si ta përdorim këtë udhëzues.....	2
Të kuptuarit e procesit të riintegrit të viktimave të trafikimit	3
Korniza e riintegrit.....	3
Tre fazat e riintegrit	9
Pengesat dhe sfidat e riintegrit	10
Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit	12
Fëmijë që ngelen pas kur prindi trafikohet	13
Fëmijë që ndodhen pranë prindit ose lindin në një situatë trafikimi.....	17
Fëmijë që lindin pas trafikimit.....	20
Nevojat e fëmijëve të viktimave të trafikimit për riintegrim.....	21
Problematikat dhe nevojat për strehim	22
Problematikat dhe nevojat shëndetësore	29
Problematikat dhe nevojat psikologjike	31
Problemet dhe nevojat ekonomike	30
Problemet dhe nevojat për arsimim dhe formim.....	39
Problemet dhe nevojat ligjore.....	41
Problemet dhe nevojat administrative	43
Marrëdhëniet dhe çështjet ndërpersonale.....	45
Çështjet në marrëdhënien prind-fëmijë.....	46
Problemet në marrëdhëniet familjare	49
Problemet në marrëdhëniet komunitare	55
Udhëzime për profesionistët.....	59
Shtojcat	55
Shtojca #1. Fjalorthi i termave	56
Shtojca #2. Modele të praktikave të mira në punën me fëmijët e viktimave të trafikimit.....	58
Shtojca #3. Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS	60

Rreth udhëzuesit të riintegrit

Çfarë është ky udhëzues

Deri më sot, riintegrimi të fëmijëve të viktimave të trafikimit i është kushtuar pak vëmendje. Këta fëmijë, ata që kanë mbetur pas, ata që janë trafikuar me prindin/prindërit e tyre dhe ata që lindur nga një situatë trafikimi, përballen me sfida serioze dhe të larmishme, jo vetëm kur prindi i tyre trafikohet, por edhe pas përfundimit të trafikimit, si dhe gjatë procesit të rikuperimit dhe riintegrit të tyre. Po ashtu, ofruesit e shërbimit përballen me një larmi kufizimesh për të mbështetur me efikasitet sigurinë, mirëqenien dhe riintegrimin afatgjatë të këtyre fëmijëve, veçanërisht duke pasur parasysh kompleksitetin dhe diversitetin e nevojave të tyre për asistencë.

Ky udhëzues riintegrimi përshkruan kategoritë e ndryshme të fëmijëve të viktimave të trafikimit që kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime riintegruese. Udhëzuesi fillon me një përshkrim të tre grupeve të fëmijëve të viktimave të trafikimit, duke përfshirë atë që kanë përjetuar vetë, si dhe për shkak të trafikimit të prindërve të tyre. Më pas, udhëzuesi paraqet çështjet dhe nevojat e ndryshme me të cilat përballen këta fëmijë pas trafikimit, ndersa punojnë për riintegrimin dhe integrimin në familjet dhe komunitetet e tyre. Udhëzuesi përmbillet me një set rekomandimesh që udhëzojnë profesionistët e riintegrit në punën e tyre të përditshme me këta fëmijë dhe familjet e tyre.



Ky udhëzues riintegrimi bazohet në përvojën e D&E dhe NEXUS në zbatimin e programeve të riintegrit për viktimat e trafikimit ndër vite, si dhe në kërkimet dhe të nxënit tonë për këtë temë të rëndësishme. Po ashtu, këta udhëzues përfshijnë përvoja nga jeta reale dhe reflektime të viktimave të trafikimit, si dhe të profesionistëve që punojnë me ta.

Audienca e synuar e këtij udhëzuesi

Ky udhëzues synon profesionistët që punojnë për rikuperimin dhe riintegrimin e të rriturve dhe fëmijëve viktimat të trafikimit në Shqipëri, si dhe në fusha të tjera. Këtu përfshihen punonjës socialë dhe asistentë socialë, psikologë dhe këshillues, profesionistë të kujdesit shëndetësor, avokatë dhe paraligjorë, staf arsimor (mësues, drejtorë shkolle, psikologë shkolle), staf i mbrojtjes së fëmijëve,

administratorë publike dhe profesionistë që punojnë në fuqizimin ekonomik dhe sistemimin në punë.

Si ta përdorim këtë udhëzues

Ky udhëzues riintegrimi është një burim praktik i veçantë që profesionistët e riintegrit mund ta përdorin në punën e tyre të përditshme të riintegrit. Ai mund të përdoret për të përgatitur dhe trajnuar profesionistë, si dhe për referim gjatë punës së vazhdueshme të riintegrit. Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrimi që shqyrtojnë aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, dhe që shpjegojnë dhe ofrojnë udhëzime se si mund të adresohen çështje dhe pengesa kyç në riintegrimin e viktimave të trafikimit.

Profesionistët e riintegrit duhet t'iu referohen udhëzuesve përkatës kur kryejnë punën e tyre me viktimat e trafikimit. Kjo seri përfshin tre udhëzues riintegrimi për aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, duke përfshirë:

- Fazat e rikuperimit dhe riintegrit të viktimave të trafikimit
- Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit
- Mentorimi i viktimave të trafikimit


Kjo seri udhëzuesish riintegrimi për profesionistët është hartuar nga Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) dhe Instituti NEXUS.

Të kuptuarit e procesit të riintegrit të viktimave të trafikimit¹

Korniza e riintegrit

Trafikimi ka ndikime shumë serioze në mirëqenien fizike, psikologjike, ekonomike dhe sociale të viktimave të trafikimit. Përveç kësaj, shumë viktima të trafikimit janë përballur me probleme në jetën e tyre përpara trafikimit, të cilat vazhdojnë edhe pas trafikimit. Probleme të tjera gjithashtu shfaqen përgjithësisht në jetën dhe marrëdhëniet e tyre gjatë periudhës së rikuperimit dhe riintegrit. Për shembull, shumë viktima kanë migruar për shkak të problemeve ekonomike në familje, dhe në përgjithësi situata e tyre ekonomike është përkeqësuar më shumë për shkak të

Për
nuk ka
vetëm
e
që ka
në
por



trafikimit.
rrjedhojë,
riintegriti
të bëjë
me
adresimin
impaktit
pasur
trafikimi
jetën e
viktimave,
edhe me
adresimin

e cenueshmërive (faktorëve vulnerabël) të situatës së para trafikimit, si dhe të sfidave që shfaqen në jetë pas përfundimit të periudhës së trafikimit dhe shfrytëzimit.

Cënueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse përpara trafikimit, për shkak të trafikimit dhe pas trafikimit

¹ Kjo pjesë bazohet në punën e kryer nga Instituti NEXUS dhe 15 OJF në Ballkan, duke përfshirë D&E, në kuadër të Programit të Riintegrit të Viktimave të Trafikimit (PRVT), të zbatuar gjatë viteve 2006-2015 dhe të financuar nga Fondacioni i Mbretit Baudouin (KBF). Për më shumë informacion rreth PRVT-së, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/trafficking-victims-reintegration-programme-tvrrp/>

Kjo pjesë bazohet edhe te puna e Institutit NEXUS në projekte të tjera, duke përfshirë: Nismën Rajonale për Riintegrit: Sfidat për Riintegritin në Nënrajonin e Mekongut të Madh, në bashkëpunim me UNIAP dhe qeveritë COMMIT në Nënrajonin e Mekongut të Madh për periudhën 2010-2017 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/commit-ppc5-regional-reintegration-initiative/>) dhe Mbrojtjen e të Paasistuarve dhe të Nënshërbyerve: Studim afatgjatë i bazuar në evidenca mbi asistencën dhe riintegritin, i zhvilluar në partneritet me Qeverinë e Indonezisë dhe partnerë të shoqërisë civile në Indonezi, për periudhën 2013-2019 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/reintegration-in-indonesia/>). Për burime dhe kërkime kyç, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>

vulnerabiliteti
para trafikimit

impakti i
trafikimit

vulnerabiliteti
pas trafikiit

Riintegrimi është proces i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai mund të kuptohet më mirë si një proces që personat e trafikuar e përshkojnë teksa rikuperohen dhe lënë pas shfrytëzimin, trafikim. Riintegrimi i suksesshëm përfshin:



Sistemimin në një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt,



Aksesin në një standard të arsyeshëm jetese,



Mirëqenien mendore dhe fizike,



Mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik, dhe



Aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale²

Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e vet të origjinës. Ai mund të përfshijë edhe integrimin në një komunitet të ri, ose madje në një shtet të ri.

Një aspekt kryesor i riintegrit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi për të qenë të pavarur dhe të vetëmjaftueshëm, dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.


Komponentët e ndryshëm të riintegrit të suksesshëm

² Ky përkufizim u zhvillua në bashkëpunim me Institutin NEXUS dhe 15 OJF partnere në kuadër të programit PRVT të KBF-së. Ju lutemi shihni: Surtees, R. (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Institutu NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin, f. 11.



Trafikimi ndikon edhe në marrëdhëniet familjare të viktimës dhe shumë viktima përballen me tensione dhe probleme në mjediset e tyre familjare, si dhe në mjedise më të gjera shoqërore. Për rrjedhojë, ka nivele të ndryshme ku mund të ndodhë riintegrimi, dhe se çfarë duhet marrë në konsideratë lidhur me mënyrën se si profesionistët punojnë dhe i mbështetin viktimat gjatë gjithë procesit të rikuperimit dhe riintegritimit. Riintegrimi nënkupton kapërcimin e këtyre problemeve dhe ndjeshmërive nëpërmjet këtyre niveleve - individual, familjar, komunitar dhe strukturor – dhe maksimizimin e burimeve të ripërteritjes dhe mbështetjen në jetën e viktimave dhe në mjedisin e gjerë.

Nivelet e riintegritimit: individual, familjar, komunitar dhe strukturor³



³Surtees, R. (2017). *Të ecim përpara. Riintegrimi në familje dhe komunitet i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS; Surtees, R. (2017). *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS.



Niveli individual. Riintegrimi duhet të adresojë ndikimin e trafikimit (fizik, psikologjik, social dhe ekonomik) te vetë viktimat. Disa viktimat përballen edhe me probleme të ndërlikuara dhe të pazgjdhura, madje edhe me traumën përpara trafikimit. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e çdo viktime, si dhe kapacitetet, aftësitë dhe burimet për të ofruar asistencë të përshtatur dhe të personalizuar, dhe për të maksimizuar burimet e tyre personale të forcës dhe aftësisë ripërtëritëse.



Niveli familjar. Riintegrimi ndodh shpesh në mjedisin familjar të viktimës. Mjedisin familjar është shpesh një terren kompleks me shtresa të ndryshme mbështetjeje dhe tensionesh. Në procesin e riintegritimit mund të përfshihet një numër i madh pjesëtarësh të familjes, në shkallë dhe fazë të ndryshme të jetës pas trafikimit dhe mund të shfaqin veprime dhe reagime, qëndrime dhe sjellje të ndryshme (dhe shpesh kontradiktore), sidomos me kalimin e kohës dhe si përgjigje ndaj faktorëve të jashtëm. Disa pjesëtarë të familjes janë mbështetës dhe ndihmues; të tjerët mund të jenë kritikë dhe jombështetës. Të gjithë këta faktorë dhe ndryshime ndikojnë në mënyrë të diferencuar në rezultatet e riintegritimit për viktimat dhe familjet e tyre të gjera; disa herë pozitivisht, dhe herë të tjera negativisht. Puna me familjen përfshin nxitjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për kthimin e viktimave, dhe për jetën e familjes në përgjithësi. Gjithashtu, ajo përfshin shpesh ofrimin e mbështetjes për pjesëtarë të ndryshëm të familjes, si për shembull mbështetje për regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës për fëmijët e viktimave të trafikimit ose mundësi punësimi për prindërit e viktimave të trafikimit.



Niveli komunitar. Mjedisin komunitar është një faktor i rëndësishëm në suksesin ose dështimin e riintegritimit të viktimave. Komuniteti përfshin ata që janë pranë dhe që përfshihen ngushtësisht në jetën e një viktime të trafikimit, si dhe ata në sferën e gjerë (dhe më distante) shoqërore të viktimës (shokë, të afërm, fqinj, bashkëmoshatarë, kolegë pune, drejtues komuniteti). Mjedisin komunitar mund të jetë një mjedis kompleks dhe kontradiktor, i cili është mbështetës dhe jombështetës dhe përfshin reagime të ndryshme (madje kontradiktore) nga shokët, fqinjët dhe të tjerët, duke përfshirë ndryshime me kalimin e kohës. Në nivel komunitar, është e rëndësishme të vlerësohet dhe nxitet një mjedis i shëndetshëm nëpërmjet krijimit të rrjeteve shoqërore, sigurimit të disponueshmërisë dhe aksesit në shërbime dhe mundësi, dhe punës me pjesëtarët e komunitetit për të luftuar stigmën dhe diskriminimin.



Niveli strukturor. Riintegrimi në shoqërinë formale dhe institucionet e saj përfshin garantimin se viktimat e trafikimit kanë status juridik, i cili iu jep atyre të drejtën për shërbime dhe që këto shërbime të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme, veçanërisht në nivel vendor ku këto viktimat të trafikimit riintegrohen.

Rezultatet e riintegritimit të suksesshëm⁴

Riintegrimi i suksesshëm në përgjithësi do të thotë se viktimat e trafikimit kanë arritur rezultatet të paraqitura si më poshtë.

⁴ Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integritimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin.



Për të arritur këto rezultate, viktimat e trafikimit kërkojnë mbështetje dhe shërbime të ndryshme për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas trafikimit. Ata mund të kërkojnë një shërbim të vetëm (për shembull, transport, kujdes mjekësor për urgjencë, sistemim në punë) ose shërbime të shumëfishta (për shembull, një ndërthurje e strehimit, asistencës mjekësore, kujdesit psikologjik, mbështetjes ligjore, arsimit dhe formimit profesional). Shërbimet mund të jenë specifike për trafikimin (të ofruara nga organizata dhe institucione kundër trafikimit) ose mund të jenë më të përgjithshme (për shembull, të ofruara nga agjenci/institucione që punojnë me personat e cenusshëm, migrantët e kthyer, zhvillimin komunitar, mbrojtjen e fëmijëve). Një paketë gjithëpërfshirëse e asistencës për riintegrim përfshin format e mbështetjes, shërbimet të paraqitura më poshtë.

Asistenca dhe shërbimet për rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit⁵



Strehim, akomodim dhe alternativa të kujdesit. Ofrimi i akomodimit të sigurt, të kënaqshëm dhe të përballueshëm dhe i alternativave të kujdesit (për shembull, në një strehëz, duke jetuar me familjen, në apartament me qira, familje kujdestare, sistemim alternativ).

⁵Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2017) *Mbështetja e riintegritit të personave të trafikuar. Udhëzues për Nënrajonin e Mekongut të Madh*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bangkok: UN-ACT dhe World Vision; dhe Surtees, R. et al. (2016) *Të shkojmë në shtëpi: Riintegrimi i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS.



Asistencë mjekësore. Asistencë dhe kujdes mjekësor i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, duke përfshirë kujdesin dentar, trajtimin mjekësor të specializuar kur nevojitet, dhe trajtimin për probleme shëndetësore kronike dhe të vazhdueshme.



Mbështetje dhe këshillim psikologjik. Mbështetje dhe këshillim psikologjik i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë (për shembull, këshillim individual dhe në grup, terapi përmes artit, muzikës dhe kërcimit, këshillim familjar).



Arsim, formim dhe aftësi për jetën. Mundësi për arsim formal dhe joformal, duke përfshirë shkollim, mbështetje për rifutjen në shkollë, formim profesional, trajnim profesional, trajnim për aftësi jetësore, dhe tutorim, këshillim dhe orientim mbi trajnime profesionale.



Mundësi për fuqizim ekonomik. Mundësi për fuqizim ekonomik, duke përfshirë sistemimin në punë, stazhin, aktivitete për gjenerimin e të ardhurave, zhvillim biznesi, këshillim dhe mentorim mbi mundësi punësimi dhe biznesi.



Asistencë dhe mbështetje administrative. Asistencë dhe mbështetje administrative e nevojshme për të adresuar ndikimin e trafikimit ose për të mbështetur riintegrimin (për shembull, marrja e dokumenteve të identifikimit ose dokumenteve të tjera zyrtare, certifikatës së lindjes, lejeve të banimit dhe punës si viktimat e trafikimit, dhe caktimi i një kujdestari ligjor në rastin e fëmijëve, marrja e dokumenteve për akses në shërbime, si strehim me qira ose i subvencionuar, ndihmë ekonomike, shërbime sociale, sigurime shëndetësore).



Asistencë dhe mbështetje ligjore. Asistencë dhe mbështetje për viktimat e trafikimit në procese ligjore, duke përfshirë procese gjyqësore penale, civile dhe lidhur me marrëdhëniet e punës. Asistenca dhe mbështetja juridike mund të jetë e lidhur me përvojën e tyre të trafikimit (për shembull, si viktimë-dëshmitar në procese gjyqësore penale, kërkesa për kompensim) ose me çështje të tjera ligjore të hasura gjatë riintegrimit (për shembull, divorci, aksesi ose kujdestaria e fëmijës, pronësia e pasurisë, pagesat e mbështetjes së fëmijës).



Masa të sigurisë dhe sigurimit. Masat për të garantuar sigurinë dhe sigurimin e viktimave të trafikimit në faza të ndryshme pas trafikimit, duke përfshirë vlerësime të familjes dhe rrezikut, mbrojtja e viktimës-dëshmitarit.



Asistencë për pjesëtarët e familjes së viktimës. Nxitje dhe mbështetje e një mjedisi të shëndetshëm familjar nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës për pjesëtarët e familjes së viktimës (për shembull, fëmija, bashkëshorti/bashkëshortja, motra/vëllai, prindi).



Menaxhimi i rastit. Hartimi dhe zbatimi i një plani individual të asistencës dhe riintegrit, në bashkëpunim me viktimën e trafikimit, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve ose koordinimin e referimit të viktimës në organizata/institucione të tjera për shërbime.



Asistencë për kthimin. Mbështetje për kthimin vullnetar të viktimave të trafikimit në shtetin e tyre dhe në vendin e origjinës ose banimit, duke përfshirë ofrimin e transportit dhe përgatitjen e dokumentacionit. Në disa raste, nevojat për asistencë janë rrjedhojë direkte e trafikimit.

Tre fazat e rikuperimit dhe riintegritit⁶

Riintegrimi pas përvojës së trafikimit është një proces afatgjatë që zgjat për shumë muaj dhe vite. Riintegrimi mund të zërthehet në tre faza të veçanta gjatë një periudhe rreth tre vjet.

Tre fazat e riintegritit



Faza 1. Ndërhyrja gjatë krizës (nga 0 në 6 muaj). Faza e krizës mund të zgjasë deri në gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë, në varësi të natyrës dhe shkallës së shfrytëzimit të individit, si dhe të sfidave dhe cenueshmërive para dhe pas trafikimit. Për shembull, zakonisht fëmijët kërkojnë më shumë kohë në fazën e krizës pasi kanë aftësi përballimi më pak të zhvilluara. Viktimat në rrezik për sigurinë (për shembull, për shkak se kanë denoncuar trafikantin e tyre) kërkojnë shpesh më shumë kohë në këtë fazë. Viktimat që janë gra shtatzëna ose të shoqëruara me fëmijët e tyre qëndrojnë zakonisht për periudha më të gjata kohore në këtë fazë krize, pasi kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime gjatë periudhës para dhe pas lindjes, duke përfshirë aftësitë e prindërimit. Gjithashtu, ato kanë nevojë për mbështetje në trajtimin e traumës dhe qëndrueshmërinë e tyre emocionale, sidomos për të qenë në gjendje që të kujdesen për fëmijët e tyre. Shumë viktime me probleme të shëndetit mendor kanë nevojë për mbështetje më afatgjatë dhe më intensive në fazën e krizës, dhe shpesh edhe pas kësaj faze.



Faza 2. Tranzicioni (nga 7 në 12 muaj). Faza e tranzicionit zgjat zakonisht rreth gjashtë muaj (nga muaji i 7-të tek i 12-ti i procesit të riintegritit). Megjithatë, kjo periudhë mund të jetë më e shkurtër në situatat kur viktimat kanë një profesion ose kanë përvojë të mëparshme pune, ose nëse kanë një mjedis të shëndetshëm familjar ku mund të kthehen. Por, mund të jetë edhe më e gjatë në rast se viktimat kanë nivel të ulët arsimor ose nuk kanë përvojë formimi profesional apo pune. Në përgjithësi, edhe fëmijët kanë nevojë për më shumë kohë në këtë fazë, kryesisht ata me marrëdhënie jo të mira me prindërit, ose ata që kanë marrëdhënie familjare të vështira ose të pashëndetshme.



Faza 3. Riintegrimi dhe përfshirja (nga 13 në 36 muaj). Faza e riintegritit dhe përfshirjes zgjat zakonisht dy vjet, gjatë muajve 13-36, por varion nga njëra viktimitë te tjetra, dhe në varësi të

⁶ Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin.

përvojave të tyre jetësore specifike dhe të kushteve të riintegrit. Disa viktimat mund të lëvizin më shpejt gjatë fazës së riintegrit dhe përfshirjes (për shembull, kur kanë një punë të qëndrueshme, mbështetje nga familja e tyre, një vend për të jetuar, një mjedis shoqëror të shëndetshëm dhe akses në shërbime komunitare).

Procesi i plotë i rikuperimit dhe riintegrit (kriza, tranzicioni, dhe riintegrit e përfshirja) zgjat zakonisht rreth tre vjet. Megjithatë kjo ndarje dhe afat kohor ofron një orientim të dobishëm, secila viktimë ka nevojë për periudha të ndryshme kohore për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas një përvoje trafikimi. Disa viktimat riintegruohen me sukses përpara përfundimit të kësaj periudhe trevjeçare. Viktimat tjerë të trafikimit mund të kenë nevojë për pesë vjet që të rikuperohen nga shfrytëzimi i tyre, në mënyrë që të riintegruohen me sukses. Profesionistët e riintegrit duhet të jenë fleksibël në hartimin dhe zbatimin e çdo plani riintegrit, duke përfshirë afatet e nevojshme kohore. Nevoja për një afat kohor më të gjatë për riintegrit është e zakonshme te viktimat "problematike" ose "komplekse", pra te viktimat me vështirësi akute ose nevojave komplekse, ose që janë marrë më pak në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit.⁷ Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, viktimat të trafikimit:

- ☼ Me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore
- ☼ Me probleme me abuzimin me substanca
- ☼ Me probleme të shëndetit mendor
- ☼ Me gjendje mjekësore të rëndë ose kronike
- ☼ Me probleme të sigurisë
- ☼ Pa dokumente ose status juridik
- ☼ Pa mbështetje familjare
- ☼ Që kanë pasur përvoja me të qenit të marginalizuar ose diskriminuar në aspektin social (duke përfshirë minoritete etnike, kombësi të ndryshme, dhe individë që identifikohen si **(LGBTQ+)**)
- ☼ Me përvoja të shkuara të abuzimit, dhunës ose neglizhencës (veçanërisht në mjedis familjar)
- ☼ Që janë të shtatzëna ose që kanë fëmijë në varësi (veçanërisht prindërit e vetëm)
- ☼ Që nuk janë marrë mjaftueshëm në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit (burra dhe djem të trafikuar)

Rastet "e vështira" ose "komplekse" kërkojnë shpesh akses në shërbime të shumfishta dhe të vazhdueshme, kujdes të specializuar ose mbështetje intensive gjatë një periudhe më të gjatë se ajo e zakonshme, si dhe menaxhim më intensiv të rastit dhe/ose mbështetje afatgjatë për riintegritin.

Pengesat dhe sfidat e riintegrit


Riintegriti kuptohet shpesh si proces linear, në të cilin viktimat bëjnë gradualisht hapa përpara drejt rikuperimit dhe riintegrit. Megjithatë, realiteti është shumë më kompleks. Shumë viktimat trafikimi përballen me kriza dhe pengesa në faza të ndryshme gjatë riintegrit të tyre, të cilat mund të frenojnë progresin e tyre ose madje edhe të sjellin regres në hapat e mëparshëm të riintegrit. Krizat dhe vështirësitë e zakonshme në procesin e riintegrit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ☼ Vështirësitë ekonomike dhe krizën financiare, duke përfshirë mungesën e mundësive të punësimit ose humbjen e vendit të punës
- ☼ Problemet e shëndetit mendor që mund të shfaqen në faza të ndryshme
- ☼ Sëmundjet ose lëndimet që ndikojnë në mirëqenien ose aftësinë për punë
- ☼ Konfliktet, tensionet dhe mosmarrëveshjet në familje

⁷ Për trajtimin e riintegrit të viktimave në situata të vështira, ju lutemi shihni: [Surtees, R. \(2008\) Riintegriti i personave të trafikuar. Trajtimi i rasteve "problematike".](#) Uashington, D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin.

- ☸ Dhunën dhe abuzimin në familje (dhuna në familje, abuzimi i fëmijëve, incesti)
- ☸ Tensionet dhe konfliktet me pjesëtarët e komunitetit
- ☸ Çështjet e sigurisë si viktimë-dëshmitar (kërcënime dhe kanosje, kur trafikanti shpallet i pafajshëm ose del nga burgu)
- ☸ Procesin e gjatë gjyqësor dhe mungesën e aksesit efikas në drejtësi
- ☸ Problemet shëndetësore që prekin viktimat ose familjet e tyre (duke përfshirë ndikimin në kostot për kujdes shëndetësor)
- ☸ Përfundimin e asistencës së rregullt dhe mbështetjes e ndjekjes së riintegrit
- ☸ Vështirësitë e hasura nga disa përfitues për të qenë të pavarur dhe autonomë
- ☸ Ngjarjet e jashtme dhe krizat, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, si tërmetet dhe pandemitë botërore

Pengesat dhe sfidat gjatë procesit të riintegrit



Në rastin e fëmijëve, pengesat mund të lindin nga vështirësitë në regjistrimin ose vazhdimin e arsimit, dhe nga mungesa e shërbimeve dhe procedurave specifike për fëmijën ose të ndjeshme ndaj fëmijës në nivel vendor. Në përgjithësi, fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë mund të jenë më të ekspozuar ndaj pengesave dhe krizave, për sa u përket kapaciteteve të tyre zhvilluese, identiteteve të tyre ende në zhvillim dhe varësisë së tyre të madhe nga familja dhe të rriturit e tjerë që kujdesen për ta. Po ashtu, fëmijët janë mjaft të cenueshëm ndaj hakmarrjes së trafikantëve dhe dhunës fizike dhe emocionale në përgjithësi, në mjedise të ndryshme (shtëpi, shkollë, komunitet).

Fakti nëse këto pengesa e devijojnë në mënyrë të përkohshme apo të përhershme procesin e riintegrit të përfituesit është një funksion i rrethanave të tyre individuale (mekanizmat e tyre individuale ose sociale të përballimit) dhe i mbështetjes së disponueshme nëpërmjet programeve të riintegrit. Të qenit në gjendje për t'u mbështetur te dikush në familjen ose rrjetin e vet shoqëror është pjesë përbërëse e të qenit në gjendje për të përballuar dhe kapërcyer problemet dhe pengesat që mund të lindin. Alternativa e kthimit për mbështetje dhe shërbime riintegritimi në çdo fazë të jetës pas trafikimit të dikujt është e rëndësishme për të zbutur pengesat. Megjithatë mbështetja mund të jetë specifike për trafikimin, është e rëndësishme që të merren në konsideratë dhe të maksimizohen forma të tjera në nivel komunitar, si shërbime sociale të qeverisë qendrore, OJF vendore, organizata fetare dhe grupe komunitare.⁸

⁸ Surtees, R. (2008) *Riintegritimi i personave të trafikuar. Si mund të jetë më efektive puna jonë*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar*

Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit

Për të mbështetur rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit është e rëndësishme të kuptohen përvojat dhe nevojat e tyre. Ndjesia fillestare e gëzimit dhe çlirimit pasi kanë shpëtuar nga trafikimi dhe shfrytëzimi zëvendësohet me emocione negative, pasi viktimat e trafikimit përpiqen të kuptojnë më mirë traumat e shkaktuara nga trafikimi dhe dëshirojnë të rikuperohen dhe të riintegrohen. Shpeshherë ato nuk ndihen mirë psikologjikisht dhe fizikisht, si dhe ndeshin vështirësi ekonomike, probleme me sigurinë për shkak të kërcënimeve dhe hakmarrjes nga trafikantët, problematika në marrëdhënie familjare, si dhe sfida në mjediset komunitare, duke përfshirë stigmatizimin dhe diskriminimin.

Veç kësaj, një ndër problematikat më të mëdha për shumë viktimat trafikimi është mirëqenia e fëmijëve të tyre, si dhe marrëdhënia e tyre me ta pasi ka marrë fund trafikimi. Fëmijët e viktimave të trafikimit janë të prekur thellësisht dhe drejtpërdrejt nga trafikimi i prindërve të tyre, si dhe nga vështirësitë që shoqërojnë rikuperimin dhe riintegrimin e tyre. Çdo ditë, fëmijët ndeshen me ndikimin fizik dhe psikologjik të trafikimit mbi prindërit e tyre, si dhe vështirësitë e tyre në përballimin dhe rikuperimin nga shfrytëzimi. Këta fëmijë shpeshherë kanë edhe problemet dhe sfidat e veta, që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e trafikimit të prindërve të tyre. Fëmijët e viktimave të trafikimit që kanë nevojë për mbështetje në procesin e rikuperimit dhe riintegrimin ndahen në tri kategori:



Fëmijë që ngelen pas kur prindi trafikohet



Fëmijë që ndodhen pranë prindit ose linden në një situatë trafikimi



Fëmijë që linden pas trafikimit



Emëruesi i përbashkët i të trija grupeve të fëmijëve është ndikimi i trafikimit. Trafikimi ka pasoja të mëdha dhe të rënda psikologjike dhe fizike... por përvoja e çdo fëmije është ndryshe dhe specifike, dhe niveli i “shokut” nga trafikimi nuk është i njëjtë. Krahas kësaj, rrethanat e jetës janë të ndryshme për çdo individ, si: prania e prindërve, të afërmve dhe gjyshërve, kohëzgjatja e ekspozimit ndaj trafikimit, gjendja psikologjike dhe fizike e prindit, si dhe vendndodhjes së fëmijës dhe prindit gjatë shfrytëzimit. Procesi mund të lehtësohet ose të rëndohet nga faktorë të tjerë, si: nevojat financiare, niveli arsimor, mjedisi i sigurt, hapësirat fizike, respekti, ndjenja e sigurisë dhe e përkatësisë, dashuria dhe mbështetja. Personat që ndodhen pranë dhe kontribuojnë në jetën e këtyre fëmijëve mund ta lehtësojnë ose ta rëndojnë traumën. Çdo fëmijë dhe çdo familje kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes në mënyrë që të rikuperohen dhe të integrohen plotësisht në jetë. (Punonjës social)



Këto kategori të ndryshme fëmijësh kanë shumë nevojat dhe problematika të ngjashme gjatë fazës

viktimat: Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 188-89.

së riintegrit. Në të njëjtën kohë, midis përvojave dhe nevojave të tyre ka edhe disa dallime të rëndësishme, që kërkojnë vëmendje dhe kujdes të posaçëm sa i përket shërbimeve dhe mbështetjes së riintegrit. Në disa raste, fëmijë të ndryshëm nga një familje janë pjesë e kategorive të ndryshme (p.sh kur prindi trafikohet me njërin fëmijë, ndërsa fëmijën tjetër e lë pas, ose kur nëna lë pas fëmijën e saj dhe sjell në jetë një fëmijë gjatë periudhës së trafikimit apo kthehet shtatzënë pas trafikimit). Në këto situata, fëmijë të ndryshëm brenda të njëjtës familje do të kenë përvoja dhe nevoja të ndryshme, të cilat kërkojnë vëmendje.

Fëmijët e viktimave të trafikimit – fëmijët që ngelen pas dhe fëmijët që lindin nga trafikimi
“Paola”⁹ ishte e martuar dhe kishte dy fëmijë. Pasi marrëdhënia e saj me të shoqin u përkeqësua, ajo vendosi të largohej nga shtëpia bashkë me fëmijën më të vogël, duke lënë pas fëmijën e madh i cili vuante nga autizmi. Ajo u trafikua dhe u shfrytëzua seksualisht nga persona, që e mbyllnin në dhomë dhe e shfrytëzonin fizikisht dhe seksualisht për muaj me radhë në praninë e fëmijës së saj. Ky trafikim la shenja fizike dhe psikologjike si mbi nënën, ashtu edhe mbi fëmijën e saj. Krahas kësaj, fëmija, të cilin Paola e la në shtëpi, e vuajti shumë ndarjen nga mamaja dhe motra.

Për këtë arsye, mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit është një pjesë e rëndësishme e riintegrit, dhe profesionistët nuk duhet të punojnë vetëm me viktimat e trafikimit, por edhe me fëmijët dhe familjen e gjerë. Udhëzuesi i riintegrit përshkruan përvojat e secilës kategori të fëmijëve të viktimave, si dhe nevojat për ndihmë dhe përvojat e tyre pasi trafikimi ka marrë fund.¹⁰

⁹ Të gjithë emrat janë ndryshuar për të mbrojtur privatësinë e individëve të përfshirë.

¹⁰ Rreth fëmijëve të viktimave të trafikimit, duke përfshirë fëmijët që kanë lindur në situata trafikimi, është realizuar vetëm një numër i vogël studimesh. Ju lutem shihni: Brunovskis, A. dhe R. Surtees (2012) *A fuller picture. Addressing trafficking-related assistance needs and socio-economic vulnerabilities*. [Një tablo e plotë. Adresimi i nevojave për ndihmë dhe cenueshmërisë socio-ekonomike lidhur me trafikimin]. Oslo: Fafo dhe Uashington, D.C.: NEXUS Institute; Brunovskis, A. and R. Surtees, R. (2012) ‘Coming home: Challenges in family reintegration for trafficked women’, [Kthimi në shtëpi: Sfidat e riintegrit në familje të grave të trafikuar], *Punë Sociale Cilësore*, 12(4), fq. 454–472.; Brunovskis, A. and R. Surtees (2012) *No place like home? Challenges in family reintegration*. [Nuk ka si shtëpia? Sfidat e riintegrit të familjes]. Oslo: Fafo and Washington, D.C.: NEXUS Institute; Busch-Armendariz, N.G., M.B. Nsonwu dhe L.C. Heffron (2011) ‘Human trafficking victims and their children: Assessing needs, vulnerabilities, strengths, and survivorship’ [Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe fëmijët e tyre: Vlerësimi i nevojave, cenueshmërisë, pikave të forta, dhe aftësive për mbijetesë], *Buletini i Kërkimit të Aplikuar mbi Fëmijët: Informimi i Politikave për Fëmijët në Rrezik*, 2; Peled, E. dhe A. Parker (2013) ‘The mothering experiences of sex trafficked women: Between here and there’ [Përvojat e grave të trafikuar seksualisht në mëmësi: Në mëdyshje], *Buletini Amerikan i Ortopsikiatrisë*, 83(4); Surtees, R. (2017) *Our Lives. Vulnerability & resilience among Indonesian trafficking victims*. [Jetët tona. Cenueshmëria dhe aftësitë ripërtëritëse të viktimave indoneziane të trafikimit]. Uashington DC: NEXUS Institute; Surtees, R. (2017) *Moving on. Family & community reintegration among Indonesian trafficking victims*. [Hapat përpara. Riintegritimi i viktimave indoneziane të trafikimit në familje dhe komunitet.] Uashington DC: NEXUS Institute; [Surtees, R. \(2016\)](#) ‘What’s home? (Re)integrating children born of trafficking’, [Çfarë është shtëpia? (Ri)integritimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40(1-2); Surtees, R. (2013) *After trafficking: Experiences and challenges in the (re)integration of trafficked persons in the Greater Mekong Sub-region*. [Pas trafikimit: Përvojat dhe sfidat e (ri)integritimit të personave të trafikuar në nënrajonin e Mekongut të Madh] Bangkok: UNIAP & NEXUS Institute; Surtees, R. (2008) *Re/integration of trafficked persons: Handling difficult cases*. [Ri/integritimi i personave të trafikuar: Trajtimi i rasteve të vështira] Uashington D.C.: NEXUS

Fëmijë që ngelen pas kur prindi trafikohet

Shumë viktime të trafikimit janë prindër, dhe statusi i tyre si mama apo baba (dhe nevoja për të mbështetur familjen e tyre) është faktor i rëndësishëm në vendimin e tyre për të migruar. Ndonëse nuk është vendim i lehtë, shpeshherë shumë familje duhet t'i lënë fëmijët pas si strategji mbijetese për të migruar. Në disa raste, fëmijët ngelen pas kur e ëma trafikohet, ndërsa në raste të tjera, fëmijët lihen pas nga babi i trafikuar. Disa fëmijë lihen pas edhe nga dy prindër migrantë. Fëmijë që kanë ngelur pas kalojnë përvoja të ndryshme në varësi të rrethanave ku jetojnë teksa prindi i tyre trafikohet, si dhe të specifikave rreth situatës së trafikimit të prindit të tyre (pra, a ka pasur apo jo kontakt me fëmijën apo a ka sjellë apo jo para në shtëpi).



Fëmijët që janë lënë pas nga babai dhe/ose nëna

“Amir” është i martuar dhe ka një fëmijë pesë vjeç. Ai është i vetmi person që sjell të ardhura në familje, dhe është zhvendosur jashtë vendit me shpresën që të fitojë më shumë para për të mbështetur familjen dhe për të rritur fëmijën e tij. Megjithatë, në të vërtetë migrimi i tij ishte trafikim i personave dhe ai u detyrua të jetonte dhe të punonte në kushte shumë të këqija. Atë e detyruan të punonte për të më shumë se dymbëdhjetë orë çdo ditë, i morën dokumentet, dhe e paguan më pak sesa i kishin premtuar. Gjatë periudhës së trafikimit, ai nuk mund të sillte para pranë familjes së tij, ndaj gjendja ekonomike u rëndua jashtë mase. Familja e tij ishte shumë e shqetësuar për mbijetesën dhe nuk dinin asgjë rreth Amirit gjatë periudhës së trafikimit. Ata nuk e dinin as nëse ai ishte ende gjallë. Si përfundim, Amiri ia doli të arratisë dhe të kthehej në shtëpi, por ishte në një gjendje shumë të rënduar fizike dhe mendore, çka preku edhe familjen e tij.

“Mirela” është nënë e dy vajzave. Ajo është e divorcuar dhe bashkëshorti jeton jashtë vendit. Duke qenë personi i vetëm përgjegjës për kujdesin ndaj vajzave dhe duke pasur probleme ekonomike, Mirela vendosi të migronte për qëllime pune. Ajo ra viktimë e trafikimit dhe nuk arriti të kthehej në shtëpi apo të dërgonte para për të mbështetur vajzat e saj. Gjatë kësaj kohe, vajzat mbetën vetëm në shtëpi dhe “Alina”, vajza e madhe, por ende e mitur, u desh të kujdesej për motrën e saj. Ato kishin disa të afërm që jetonin pranë tyre dhe iu jepnin ndonjëherë ushqim, por nuk kishin mbështetje nga askush tjetër. Gjatë kësaj periudhe, të dyja vajzat, veçanërisht Alina, hasën shumë probleme në jetën e tyre të përditshme, duke përfshirë braktisjen e shkollës dhe shoqërimin me njerëzit e gabuar. Duke qenë se në shumicën e rasteve iu mungonte mbikëqyrja e prindit, vajzat ishin të cënueshme ndaj personave që përfituan dhe i shfrytëzuan. Disa kohë më vonë ato u referuan në një qendër rezidenciale.

Disa fëmijë lihen me prindin që mund të kujdeset për ta gjatë kohës kur prindi tjetër mungon. Krahas kësaj, fëmijët mund të lihen nën kujdesin e familjes së zgjeruar në mungesë të prindit të tyre. Ata mund të marrin mbështetje materiale dhe emocionale nga gjyshërit apo nga hallat/tezet dhe

Institute dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin; Surtees, R. (2008) *Re/integration of trafficked persons: How can our work be more effective? [Ri/integrimi i personave të trafikuar: Si mund ta bëjmë punën tonë më të efektshme?]* Uashington D.C.: NEXUS Institute dhe Bruksel: Fondacioni Fondacioni King Baudouin.

xhaxhallarët/dajat. Disa nga këta fëmijë mund të përfitojnë kujdes të përshtatshëm teksa prindi i tyre trafikohet. Ata kanë ushqim dhe veshmbathje, shkojnë në shkollë dhe mbështeten në një mjedis familjar gjatë një periudhe kur prindi i tyre ndodhet larg.

Disa fëmijë që ngelen pas janë nën kujdesin e duhur

“Diana” është e divorcuar dhe ka një djalë. Ajo ra në dashuri dhe u zhvendos jashtë vendit me partnerin e saj për të punuar, në mënyrë që të arrinte të kujdesej për djalin e saj, të cilin e la nën kujdesin e prindërve të saj. Partneri i saj e shfrytëzoi seksualisht jashtë vendit, duke kontrolluar çdo lëvizje dhe veprimtari të sajën. Megjithatë, ajo ishte në kontakt të vazhdueshëm me prindërit dhe djalin e saj. Në disa raste, arrinte edhe të fshihte pak para për t’ua dërguar prindërve të saj në Shqipëri. Kur e zbuloi këtë gjë, partneri i saj e ndëshkoi dhe ajo nuk arriti të dërgonte më para te prindërit. Gjatë kësaj kohe, prindërit e Dianës u kujdesën shumë mirë për djalin e saj. Ai shkante në kopsht, vishej dhe ushqej mirë, si dhe kishte rezultate të mira në shkollë.

Në raste të tjera, fëmijët lihen pas në situata ku nuk kanë kujdes të përshtatshëm emocional dhe material. Disa nga këta fëmijë vijnë nga familje me një prind dhe prindi nuk mundet të kujdeset siç duhet për ta (për shkak të problemeve ekonomike ose emocionale) ose nuk interesohet për ta (i neglizhon ose i braktis).

Disa fëmijë mund të lihen nën kujdesin e të afërmeve dhe fqinjëve, që nuk mund të kujdesen mjaftueshëm për ta, veçanërisht nëse janë gjyshërit e moshuar ose nëse nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. Disa fëmijë mbeten nën kujdesin e të afërmeve, të cilët detyrohen ta pranojnë këtë përgjegjësi dhe nuk iu ofrojnë mbështetjen e nevojshme emocionale, dhe shpeshherë materiale, për zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

Disa fëmijë (më të mëdhenj në moshë) lihen vetëm në shtëpi për t’u kujdesur për veten ose nën kujdesin e vëllezërve apo motrave më të mëdha. Disa prindër i lënë fëmijët e tyre të jetojnë në qendra rezidenciale.

“ E kam pasur shumë të vështirë të kujdesem për motrën dhe vëllain. Detyra që më lanë prindërit ishte e tepërt. Isha vetëm 16 vjeçe... Po për mua kush do të kujdesej? (Vajza 16-vjeçare e një viktime trafikimi. Atë e lanë pas për t’u kujdesur për motrën dhe vëllain e saj)

”

Shumë fëmijë përballen me probleme emocionale për shkak të mungesës së njërit apo dy prej prindërve. Ata nuk kanë shumë gjasa që të kenë asnjë kontakt me prindërit e tyre gjatë trafikimit të këtyre të fundit, çka i bën të ndihen të braktisur, të neglizhuar, dhe të padashur nga prindërit e tyre (sepse fëmija nuk do ta dijë që mungesa e kontaktit ndodh kundër dëshirës së prindërve). Fëmijët mund të kenë vetëvlerësim të ulët dhe mungesë vetëbesimi për shkak të asaj që ata perceptojnë si mungesë e dashurisë dhe mbështetjes prindërore. Veç kësaj, këta fëmijë shpeshherë kanë mungesa materiale kur prindërit nuk arrijnë të dërgojnë para në shtëpi gjatë periudhës së trafikimit. Trafikimi për një kohë të gjatë dhe pamundësia për të dërguar para në shtëpi shpeshherë përkeqësojnë kushtet e jetesës së fëmijëve. Prindi apo familjari mbështetës mund të mos jetë në gjendje të mbijetojë ekonomikisht pa remitanca, gjë që shpie drejt privimit (mungesë e nevojave bazë dhe strehimit të përshtatshëm) dhe grumbullimit të borxhit.

Fëmijëve të viktimave të trafikimit mund t’iu kanoset edhe një rrezik i lartë i një sërë problemesh të tjera, si bullizmi në shkollë, apo nga bashkëmoshatarët ose fqinjët. Ama mund të ndihen ose të jenë ekspozuar ndaj diskriminimit ose stigmatizimit në komunitet për shkak të mungesës së prindërve të

tyre ose nëse situata e trafikimit bëhet publike në komunitet. Shpeshherë ata kanë vetëvlerësim të ulët dhe hasin vështirësi në krijimin e marrëdhënieve besimplota dhe të shëndetshme. Këta fëmijë mund të shfaqin sjellje agresive ose të dhunshme ndaj miqve dhe vëllezërve apo motrave të tyre për shkak të zemërimit dhe sfidave në jetë.

Fëmijët e viktimave të trafikimit janë në rrezik gjatë mungesës së prindërve të tyre

Mamaja e Janës u trafikua për shfrytëzim seksual. Gjatë mungesës së të ëmës, “Jana” u la nën kujdesin e familjes së zgjeruar në moshën 17-vjeçare. Megjithatë, ajo nuk ishte në duar të sigurta, pasi u abuzua seksualisht disa herë nga xhaxhai i saj dhe kishte frikë t’i tregonte familjes sepse mund të mos i besonin. Për këtë arsye, ajo u largua nga shtëpia dhe kërkoi ndihmë. Personi i parë që takoi ishte zemërgjerë dhe i ofroi strehë dhe ushqim. Ajo qëndroi aty për një javë. Pas një jave, personi e detyroi të prostituonte. Ajo mendonte se nuk kishte kujt t’i drejtohej dhe t’i kërkonte ndihmë. Edhe trafikanti i tha: “Askush s’do t’ia dijë për ty dhe askush nuk po të kërkon. Tani do të punosh për mua.”

“Keli” ka ardhur nga Europa Lindore dhe e ka njohur të dashurin e saj shqiptar përmes internetit. Ajo udhëtoi drejt Shqipërisë së bashku me djalin e saj 3-vjeçar për t’u takuar dhe për të vazhduar marrëdhënien me të dashurin e saj. Pas disa kohësh në Shqipëri, Keli dhe i dashuri i saj vendosën të largoheshin jashtë vendit për punë, dhe ajo e la të birin nën kujdesin e prindërve të të dashurit. Megjithatë, kur ikën jashtë vendit, Keli u shfrytëzua seksualisht nga i dashuri i saj shqiptar. Ajo nuk mundej të arratiseshin pasi ai e kërcënonte se do t’i merrte jetën e djalit të saj. Keli ishte e tmerruar nga mendimi se prindërit e të dashurit mund ta lëndonin të birin.



Fëmijë që ndodhen pranë prindit ose lindin në një situatë trafikimi

Disa fëmijë trafikohen bashkë me prindin ose prindërit e tyre (p.sh kur prindi migron së bashku me fëmijën apo familjen). Në këto raste, fëmijët mund të shfrytëzohen së bashku me prindin, duke u bërë kështu viktimë trafikimi (p.sh për punë të detyruar, lypje, veprimtari kriminale). Në raste të tjera, një fëmijë mund të jetojë me prindin teksa ky i fundit shfrytëzohet (p.sh për prostitucion ose lypje). Disa fëmijë dhe prindër ndahen me forcë nga trafikantët, në mënyrë që këta të fundit të kontrollojnë dhe mos të lejojnë prindërit të arratisen.

Fëmijët e trafikuar me prindërit

“Toni” migroi me babanë dhe motrat e vëllezërit e tij në një vend fqinj, ku babai të tij i ishte premtuar një punë dhe të ardhura të mira. Megjithatë, babanë e Tonit e mashtruan dhe e detyruan të përfshihej në veprimtari kriminale. Fëmijët shfrytëzohen dhe detyrohen të lypin nga të njëjtit persona. Pas pak kohësh, babai ndërroi jetë dhe fëmijët mbetën vetëm. Mamaja e tyre kishte migruar në vendet e Bashkimit Europian vite më parë dhe nuk kishte kontakt me familjen. Toni dhe vëllezërit dhe motrat e tij arritën të ktheheshin në Shqipëri me ndihmën e xhaxhit të tyre.

Ervisi është një djalë, mamaja e të cilit u trafikua për shfrytëzim seksual dhe ai u trafikua së bashku me të. Gjatë kësaj kohe, “Ervisi” u neglizhua rëndë emocionalisht dhe fizikisht. Ai ishte i kequshqyer dhe i pazhvilluar. Atij i mungonte një marrëdhënie e shëndetshme me të ëmën, e cila e ndikuar edhe nga shfrytëzimi i saj seksual, ndonjëherë abuzonte me të. Përveç kësaj, ai jetonte me frikë pasi kërcënohej e abuzohej nga trafikanti i të ëmës.

Kur e braktisi martesën e saj, mamaja e Tilës e mori “Tilën” me vete, duke lënë pas vëllanë e kësaj të fundit. Ato përfunduan në rrugë dhe një burrë i joshi në shtëpinë e tij, ku e ëma u shfrytëzuar seksualisht për shumë muaj në praninë e saj.

“Rona” u trafikua me të ëmën, e cila u trafikua për shfrytëzim seksual. Atë e kyçën në dhomë me të ëmën ndërkohë që kjo e fundit detyrohej të kryente marrëdhënie seksuale me klientët. Krahas kësaj, ajo u ekspozua ndaj situatave dhe sjelljeve të rrezikshme nga trafikantët, duke përfshirë kërcënimet, intimidimin, dhe dhunën ndaj saj dhe të ëmës. Duke e parë të ëmën në atë gjendje, Rona u ndikua rëndë nga kjo përvojë dhe më pas shfaqte shenja traume. Zhvillimi i saj nuk ishte në përputhje me moshën kronologjike dhe ajo shfaqte atashim të papërshtatshëm ndaj të panjohurve, veçanërisht meshkujve. Ajo kishte makthe dhe lagte shtratin.

Disa fëmijë lindin si pasojë dhe gjatë trafikimit të mamasë së tyre. Kjo ndodh zakonisht kur gratë trafikohen përmes martesave të detyruara dhe babai i fëmijës është “bashkëshorti”, ose kur gratë trafikohen për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe lindin një fëmijë, babai i të cilit është trafikanti ose një klient. Gjithashtu, mund të ndodhë që gruaja të përdhuhet gjatë kohës kur trafikohet për punë (p.sh kur një grua trafikohet për punë në sektorin e shërbimit dhe përdhuhet nga “punëdhënësi”).

Fëmijët që kanë lindur në një situatë trafikimi

“Anita” u trafikua për prostitucion dhe më pas u mor si “bashkëshorte” nga trafikanti i saj. Ajo mbeti shtatzënë me bashkëshortin/trafikantin e saj dhe lindi një vajzë. Ai ishte i alkoolizuar dhe i dhunshëm dhe Anita vuajti shumë, pasi ai e rrihte vazhdimisht në praninë e vajzës së saj: “Kur më rreh, më rreh aq fort sa që nuk e njoh fytyrën time të nesërmen”.¹¹

“Ina” është trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual jashtë vendit nga i dashuri. Ajo mbeti shtatzënë disa herë gjatë shfrytëzimit seksual dhe i dashuri/trafikanti i saj e detyroi të abortonte. Në disa raste, ajo e humbi fëmijën për shkak të dhunës fizike nga i dashuri/trafikanti. Kur mbeti shtatzënë, ajo vendosi ta mbante fëmijën dhe mos t’i tregonte të dashurit/trafikantit për disa muaj. Kur shtatzënia u bë e dukshme, ajo vendosi të arratisej për ta mbajtur fëmijën, ndonëse kishte frikë nga ajo që mund t’i bënte ai nëse e kapte. Ajo arriti të zhdukej dhe më pas solli në jetë djalë e saj në një spital në vendin e destinacionit, para se të kthehej në shtëpi në Shqipëri.

“Mia” solli në jetë një djalë gjatë periudhës kur po trafikohej jashtë vendit për shfrytëzim seksual. Kur djali ishte dy vjeç, ajo dhe trafikanti (i dashuri) u kthyen në Shqipëri. Ajo ua prezantoi trafikantin prindërve të saj si bashkëshort, pasi e kishte shumë frikë. Ajo dëshironte ta denonconte, por kishte frikë se mos lëndonte fëmijën e saj. Një ditë, ajo vendosi të shkonte në polici dhe ta raportonte. Kur e zbuloi, ai i tha policisë që ajo ishte gruaja e tij dhe se kishin një fëmijë së bashku. Pas analizave të ADN-së u zbulua se fëmija nuk ishte i tij. Ajo kishte mbetur shtatzënë gjatë shfrytëzimit seksual, pasi disa klientë nuk pranojnë të përdorin mbrojtje gjatë marrëdhënieve seksuale.

Në shumë prej këtyre rasteve, fëmijët lindin dhe jetojnë për vite me radhë në një situatë trafikimi bashkë me të ëmën dhe janë nën kontrollin e trafikantit. Fëmijët që lindin në situata trafikimi mund të abuzohen ose të shfrytëzohen së bashku me mamatë e tyre dhe/ose mund të dëshmojnë shfrytëzimin dhe abuzimin e mamave të tyre gjatë trafikimit.

Fëmijët e trafikuar me një prind ose fëmijët që kanë lindur gjatë trafikimit ekspozohen ndaj një sërë shkeljesh të ndryshme, që ndikojnë te zhvillimi dhe mirëqenia e tyre. Këta fëmijë që në moshë shumë të vogël janë ekspozuar ndaj dhunës dhe brutalitetit kundër tyre dhe prindit të tyre.

“ Fëmijët... jetojnë me të “rriturit e gabuar”, me kriminelë, trafikantë, dhe njerëz agresivë. Ata e fillojnë jetën në kushte të skajshme. Ndonjëherë kur përpiqemi t’i përfshijmë në mjediset e fëmijëve, si kopshti, për të ndërvepruar me fëmijët e tjerë, ne vërejmë që hasin probleme në krijimin e një marrëdhënieje. Ne shohim që ata kanë probleme të sjelljes dhe vështirësi në krijimin e marrëdhënieve me fëmijët e tjerë. Ose mund të jenë shumë të lumtur... kur shkojnë në kopsht. (Punonjës social)¹²

¹¹ [Surtees, R. \(2017\)](#). ‘What’s home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 80.

¹² [Surtees, R. \(2017\)](#). ‘What’s home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 80.

Shpeshherë ata vuajnë nga problemet psikologjike, që shkaktohen nga dhuna që kanë përjetuar prindërit e tyre ose ata vetë.

Këta fëmijë, shpeshherë edhe në moshë shumë të vogël, janë ekspozuar ndaj dhunës dhe brutalitetit të ushtruar mbi ta dhe prindërit e tyre.

Veç kësaj, ata mund të pësojnë edhe dëmtime fizike për shkak të dhunës ose kushteve të këqija të jetesës. Shpeshherë jetojnë në kushte të papranueshme dhe varfëri të skajshme (p.sh pa ushqim dhe veshmbathje, arsim apo kujdes shëndetësor). Vuajtja e skajshme që pësojnë prindërit nënkupton edhe se nuk arrijnë gjithmonë t'i ofrojnë fëmijës kujdesin, dashurinë dhe mbështetjen e nevojshme.

Në shumë raste, këta fëmijë janë ekspozuar ndaj të rriturve negativë dhe të dëmshëm, çka ndikon në mënyra se si i kuptojnë marrëdhëniet dhe si sillen. Ndonjëherë këta fëmijë e imitojnë këtë sjellje me bashkëmoshatarët e tyre pa e kuptuar që nuk është as e pranueshme as normale.

Krahas kësaj, shumë nga këta fëmijë janë shfrytëzuar dhe janë trafikuar së bashku me prindin e tyre, gjë që do të thotë se iu duhet kushtuar vëmendje eksperiencave të tyre specifike të trafikimit dhe nevojave për mbështetje.

“ Ndonjëherë mamaja mund t'i ketë lënë fëmijët vetëm kur është detyruar të punojë me klientët. Ose mund të ketë pasur raste, të cilat janë shumë të vështira, kur i është dashur të pranojë klientë në praninë e fëmijës. Këto janë situata shumë të rënda. Kemi pasur një situatë ku mamaja vuan nga problemet e shëndetit mendor dhe e merrte fëmijën kudo, edhe në hotele... Ose ka pasur situata kur trafikantët e shfrytëzonin mamanë për prostitucion ose shitje lëndësh narkotike, ndërsa fëmijën për lypje. (Punonjës social)¹³ ”

“ Ndonjëherë trafikantët i përdorin fëmijët, që lindin gjatë trafikimit, si një pretekst dhe justifikim që vajzat mos t'i raportojnë në polici për shfrytëzim duke mashtruar se janë të martuar dhe kanë sjellë në jetë një fëmijë. (Punonjës social) ”

¹³ [Surtees, R. \(2017\)](#) 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 80.



Fëmijë që lindin pas trafikimit

Disa viktimi trafikimi mbeten shtatzënë gjatë trafikimit. Disa mbeten shtatzënë gjatë trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual ose gjatë një martese të detyruar. Të tjera mbeten shtatzënë pasi janë përdhunuar gjatë trafikimit, si nga “punëdhënësi” i tyre kur janë trafikuar për forma të ndryshme pune. Këto viktimi mund të lindin pasi dalin nga situata e trafikimit, por gjenden ende në vendin e destinacionit. Viktimi të tjera lindin pasi janë arratisur ose pasi kanë dalë nga situata e trafikimit dhe janë kthyer në vendin e tyre të origjinës.

Fëmijët që kanë lindur pas trafikimit janë ekspozuar që në mitër ndaj kushteve të jetesës dhe dhunës së pësuar nga e ëma gjatë trafikimit, duke përfshirë kequshqyerjen, abuzimin me substancat, dhe dhunën. Kjo mund të shkaktojë probleme zhvillimore, si dhe probleme shëndetësore për këta fëmijë.

Shumë nëna hasin probleme me atashimin ndaj fëmijëve pasi kanë lindur gjatë situatës së trafikimit ose për shkak të ngjarjeve të rënda traumatike në jetën e tyre. Disa nëna i braktisin fëmijët e tyre, sepse ata vuajnë nga probleme të shëndetit mendor ose sepse nuk janë mirë fizikisht. Ndërsa disa të tjera nuk mund ti mbështesin fëmijët dhe i braktisin.

Krahas kësaj, ka edhe shumë ndërlikime kur viktimat kthehen në shtëpi shtatzënë ose me një fëmijë të lindur gjatë trafikimit. Viktimat shpesh perballen me zemerim dhe refuzim nga familja e tyre që mund të përfshijë bashkëshortin, prindërit/të afërmit ose fëmijët e lënë pas.



Foshnjat priren ta ndjejnë ankthin dhe irritimin e mamasë që në mitër. Një nënë e dëmtuar emocionalisht mund të zhvillojë një marrëdhënie dhe atashim jofunksional me fëmijën. Foshnja mund të kufizohet ose të neglizhohet. Disa mama bëhen tepër mbrojtëse dhe të fiksuara [në kujdesin ndaj foshnjës]. Ato priren ta mbajnë foshnjën në krahë gjatë gjithë kohës. Këto sjellje tregojnë ndjesinë e pamjaftueshmërisë ose mosgatishmërisë për të pasur një fëmijë. (Psikolog)



Fëmijët që kanë lindur në një situatë trafikimi

“Lena” ishte e martuar dhe kishte një fëmijë. Bashkëshorti i saj e dhunonte dhe e abuzonte. Kur mbeti shtatzënë me fëmijën e dytë, i shoqi e detyroi të punonte dhe të lypte në rrugë dhe ia merrte të gjitha paratë, si dhe e rrihte nëse nuk fitonte mjaftueshëm. Leo, djali i saj, lindi para kohe për shkak të dhunës së ushtruar nga bashkëshorti i Lenës. Kur lindi, ai peshonte vetëm 2.6 kilogramë. Lena u përpoq shumë herë që të ndahej nga i shoqi, por ai e detyronte të kthehej. Ajo u arratis nga i shoqi për të shpëtuar nga dhuna, por nuk mundej të kujdesej për fëmijët. Djali i parë jeton në një institucion për fëmijët, pasi ajo nuk mund të kujdesej për të. Në fillim, ajo e mbajti djalin e dytë me vete, por nuk mundi të kujdesej siç duhej as për të, për shkak edhe të traumës së saj. Ajo ishte e pasigurtë, pasi shpeshherë harronte ta ushqente dhe ta lante. Lena nuk iu kushtonte vëmendje nevojave të tij. Leo shpeshherë sëmurej dhe nuk shtonte peshë lehtësisht. Ai kishte nevojë emocionale për dashuri dhe afeksion, që i kërkonte nga kushdo që mund t’i ofronte. Pas disa muajsh përpjekjeje për t’u kujdesur për Leon, e ëma e braktisi dhe e vendosi në një tjetër institucion për fëmijët.



Nevojat e fëmijëve të viktimave të trafikimit për riintegrim

Fëmijët e viktimave të trafikimit kanë përvoja unike dhe specifike, që meritojnë një përgjigje të dedikuar dhe të posaçme. Ata kanë një sërë nevojash për ndihmë dhe kërkojnë mbështetje të vazhdueshme afatgjatë në riintegrimin e tyre. Pavarësisht këtij fakti, këta fëmijët shpeshherë nuk shihen si përfitues që kanë nevojë për ndihmë të specializuar dhe të posaçme. Në fakt, ata trajtohen më tepër si shoqërues të prindit ose nuk marrin asnjë ndihmë.









Pjesëtarët e familjes dhe të komunitetit jo gjithmonë e kuptojnë ose e vlerësojnë cenueshmërinë e thellë të këtyre fëmijëve me kalimin e kohës. Krahas kësaj, profesionistët nuk kanë gjithnjë informacione dhe njohuri rreth kësaj kategorie përfituesish, apo aftësi dhe burime për të përmbushur nevojat e tyre. Ky rast vlen veçanërisht për profesionistët jashtë kuadrin të mbrojtjes nga trafikimi, duke përfshirë punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në komunitetet vendore ose stafin e OJF-ve që punojnë për çështje të ndryshme.

Mungesa e vëmendjes dhe të kuptuarit e përvojave të këtyre fëmijëve nënkupton që shpeshherë nuk e marrin mbështetjen e nevojshme për t'u rikuperuar dhe për t'u riintegruar së bashku me prindin. Veç kësaj, kjo nënkupton se as prindërit e trafikuar nuk janë në gjendje të rikuperohen pasi hasin vështirësi me situatën familjare. Përgjithësisht ka një mungesë shërbimesh të përshtatshme për këtë kategori fëmijësh.

“ Fëmijët e viktimave të trafikimit rrezikojnë të trafikohen, përjetojnë përjashtim social dhe diskriminim. (Punonjës social)



Në seksionet e mëposhtme shqyrtohen nevojat e ndryshme të fëmijëve të viktimave të trafikimit, duke përfshirë:

-  Problematikat dhe nevojat për strehim
-  Problematikat dhe nevojat shëndetësore
-  Problematikat dhe nevojat psikologjike
-  Problematikat dhe nevojat ekonomike
-  Problematikat dhe nevojat për arsim dhe formim
-  Problematikat dhe nevojat ligjore
-  Problematikat dhe nevojat administrative
-  Problematikat dhe nevojat ndërpersonale

Problematikat dhe nevojat për strehim

Shumë viktimat të trafikimit nuk kanë shtëpi të tyre, çka do të thotë se pas trafikimit kthehen pranë familjes, ose për të jetuar me bashkëshortin/en ose me prindërit. Megjithatë, kjo mundësi nuk është e garantuar dhe shumë viktimat nuk mund të kthehen në shtëpi, pasi familjet nuk i pranojnë pas trafikimit. Për këtë arsye, pasojat fillestare të trafikimit përfshijnë strehimin si një nga nevojat më të ngutshme të viktimave, dhe rrjedhimisht të fëmijëve të tyre. Për sa i përket aksesit në strehim, ka problematika të ndryshme në varësi të situatës dhe përvojës së viktimës të trafikimit dhe fëmijës/fëmijëve.

Viktimat që kthehen në shtëpi me fëmijë ose viktimat që lindin si rrjedhojë e trafikimit mund të mos jenë të mirëpritura pranë familjeve të tyre, çka i detyron të qëndrojnë vetëm dhe të gjejnë e të paguajnë akomodimin vetë. Shpeshherë, familjarët i fajësojnë ato për atë që ka ndodhur dhe nuk e pranojnë që janë shtatzëna ose që kanë fëmijë. Gjetja e një strehimi të përshtatshëm për një nënë me fëmijë është edhe më e vështirë dhe ka më pak alternativa.

Kostoja e strehimit për viktimat me fëmijë në varësi është më e lartë sesa për ato që jetojnë vetëm apo me miq. Ka disa familje që do të dëshironin t'i pranonin fëmijët në shtëpi, por zgjedhin mos ta bëjnë këtë gjë për shkak të diskriminimit dhe stigmës në komunitet. Në disa raste, familja e këshillon viktimën që mos të kthehet në shtëpi nga frika e pasojave që mund të vuajë nga komuniteti.

Viktimat e trafikimit që kanë qenë të martuara përpara situatës së trafikimit shpeshherë divorcohen, duke e bërë të pamundur që të kthehen në shtëpinë ku kanë jetuar përpara trafikimit. Kjo mund të nënkuptojë edhe ndarjen dhe largimin e vazhduar nga fëmijët, që kanë mbetur në shtëpi kur viktimat janë trafikuar. Kjo është me e zakonshme me viktimat e trafikimit femra. Shumë baballarë të trafikuar janë në gjendje të kthehen në shtëpinë e tyre, me bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Kur nuk ndodh kjo, mundësitë për akomodimin e viktimave të trafikimit meshkuj janë të kufizuara. Në disa raste, viktimat e trafikimit kanë jetuar në institucione për fëmijët përpara se të trafikoheshin, çka do të thotë se nuk kanë një shtëpi ku të kthehen ose ku të çojnë fëmijën e tyre pasi arratisen nga trafikimi.

Fill pas trafikimit, viktimat duhet të mbështeten me akomodim. Shpeshherë, ky fakt nënkupton që ato akomodohen në strehëza në planin afatshkurtër, dhe më pas kalojnë në akomodim të pavarur ose gjysmë të pavarur. Akomodimi i mamave dhe fëmijëve të tyre në një strehëz mund të jetë sfidues, pasi nuk është një mjedis që nxit zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve.

“ Ishte e pamundur të kthehesha dhe të jetoja me familjen time. Ata nuk e dinë që jam shtatzënë. Më fajësojnë mua për atë që më ndodhi... nëse e zbulojnë se jam shtatzënë, do të marr fund (viktimitë trafikimi femër, që ka mbetur shtatzënë gjatë trafikimit).

”

“ Prindërit e mi më lejojnë të jetoj me familjen, por i druhen opinionit të fqinjëve dhe komunitetit. Ata më thanë se është më mirë të filloj një jetë të re në një qytet tjetër (viktimitë trafikimi femër, që ka mbetur shtatzënë gjatë shfrytëzimit).

”

Nëse strehëza është zgjidhja e vetme e disponueshme, për mamatë me fëmijë duhet të krijohen mjedise të përshtatshme në mënyrë që t'iu përgjigjen nevojave individuale të fëmijëve, të garantojnë shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, të mbështetin zhvillimin e çdo fëmijëve sipas moshës, të krijojnë marrëdhënie pozitive, si dhe t'i bëjnë fëmijët të ndihen si në shtëpi. Disa gra që janë shtatzëna dhe lindin gjatë jetesës në strehëz shpeshherë qëndrojnë aty për një periudhë më të gjatë, derisa ta marrin veten nga lindja e fëmijës.

Me kalimin e kohës, familjet mund të pranojnë dhe ta "falin" viktimën e trafikimit, duke i dhënë mundësinë që të kthehet dhe të jetojë me ta në planin afatgjatë. Për këtë shpeshherë kërkohet kohë dhe ndërmjetësim me familjen, duke treguar kujdes të veçantë për ta bërë familjen të kuptojë se nuk ishte faji i viktimës. Veç kësaj, duhet të adresohen edhe shqetësimet për diskriminimin e viktimës në familjen e gjerë dhe në komunitet pasi të kthehet në shtëpi pas trafikimit, me fëmijë për të cilët duhet të kujdeset.

Në raste tjera, nuk është e mundur që të kthehen në familje. Dhe vetë viktimat mund të mos e duan këtë gjë. Megjithatë, qiraja e apartamenteve kushton dhe ndonjëherë është e përbalueshme, sidomos për një prind të vetëm. Disa apartamente mund të kenë qira më të ulët, por shpeshherë kanë cilësi të paktë dhe qiramarrësit mund të hasin probleme me ajrimin, mungesën e pajisjeve shtëpiake, elektroshtëpiake, dhe mobilie. Kushtet e vështira të jetesës mund të përkthehen në probleme emocionale dhe sjellore për fëmijët dhe stres për prindërit. Shtëpitë me çmim të ulët shpesh gjenden larg qendrave të qytetit ose të qytezës, çka nënkupton kohë dhe kosto më të larta udhëtimit. Ndonëse në bashki të ndryshe ofrohen programe strehimi (p.sh strehim social, bonus qiraje), aplikimi për këto programe është shpesh i ndërlikuar dhe kërkon kohë dhe plotësimin e shumë dokumenteve

Nevojat për strehim dhe akomodim

"Arta" u trafikua për shfrytëzim seksual jashtë vendit. Ajo ngeli shtatzënë dhe u largua nga situata e trafikimit dhe u kthye në Shqipëri. Ajo u referua në një strehëz për të jetuar pasi marrëdhënia me familjen e saj nuk ishte e mirë pasi ata e fajësonin atë për trafikimin, dhe u përkeqësua më tej kur morën vesh se ishte shtatzënë. Pasi solli në jetë djalin e saj, Arta mendoi se nëse do ta takonin nipin e tyre, prindërit e saj do ta kuptonin situatën, do të bëheshin më të ndjeshëm, dhe do ta falnin atë dhe djalin e saj. Ajo e mori djalin për ta takuar me familjen e saj, por ata e detyruan që të zgjidhte midis marrëdhënies me ta dhe djalit të saj. Ajo u përpoq ta përmirësonte marrëdhënien me prindërit e saj dhe të kthehej të jetonte me ta. Megjithatë, kjo nuk ishte e lehtë dhe ajo vendosi të gjente një apartament në kryeqytet. Për ta gjetur këtë apartament, asaj i duhej të aplikonte për strehim të subvencionuar, që përfshinte përgatitjen e shumë dokumenteve dhe shumë burokracia. Aktualisht, ajo ende mbështetet në strehëz, ndërkohë që po përpiqet të zgjidhë situatën e strehimit.

"Martën" e ndihmuan strehëz së bashku me tre fëmijët e saj. Pas një viti, Marta filloi punë dhe çdo gjë po shkonte mirë. Fëmijët ishin në kopsht dhe ishin shumë të kënaqur. Marta dhe punonjësja e saj social filluan të mendonin nëse ajo mund të jetonte jashtë strehëzës, në një apartament me qira, së bashku me fëmijët e saj. Teksa përgatitej për jetesën gjysmë të pavarur, dy fëmijët e mëdhenj shprehën shqetësimet rreth jetës së tyre më vonë dhe aftësisë së mamasë së tyre për t'iu kujdesur për ta. Edhe Marta ishte e shqetësuar nëse do të arrinte të kujdesej për fëmijët dhe shpeshherë iu thoshte që mund t'i duhet t'i vendoste në një institucion për fëmijë, nëse nuk mund të kujdesej për ta. Ankthi dhe stresi i saj për jetesën e pavarur i preku shumë fëmijët. Ata ishin të shqetësuar se ajo do t'i vendoste në një institucion dhe ndiheshin të stresuar për largimin nga strehëza. Marta kishte nevojë të qëndronte pak më gjatë në strehëz për t'u përgatitur për jetën jashtë strehëzës së bashku me fëmijët e saj. Edhe fëmijët kishin nevojë për kohë që të përshtateshin dhe e kishin të vështirë ta mendonin që një ditë do të jetonin në mënyrë të pavarur.



“Klea” është shfrytëzuar seksualisht dhe lindi një vajzë jashtë vendit. Kur u kthye në Shqipëri pas përvojës së trafikimit, ajo jetoi me familjen pasi nuk kishte strehim tjetër. Por, kishte shumë persona që jetonin vetëm në dy dhoma (prindërit e saj, familja e vëllait të saj, dy motrat e saj, Klea dhe vajza e saj). Klea ishte e dëshpëruar për të gjetur një shtëpi ku mund të jetonte me vajzën e saj 8-vjeçare, por kostot e larta të apartamenteve dhe mungesa e parave ia bënë punën shumë të vështirë.

Problematikat dhe nevojat shëndetësore

Fëmijët e viktimave të trafikimit kanë problematika dhe nevoja të ndryshme, që varen nga përvojat specifike.

Fëmijët që mbeten pas shpeshherë kanë probleme shëndetësore nga kujdesi i papërshtatshëm gjatë mungesës së prindit. Në disa raste, kjo nënkupton që nuk ushqehen mirë ose nuk kanë praktika të përshtatshme higjiene (larja e duarve, higjiena orale, trajnimi për të shkuar në tualet).

Krahas kësaj, shumë fëmijë nuk marrin kujdes të rregullt mjekësor gjatë mungesës së prindit të tyre të trafikuar (kontrolle të rregullta mjekësore, vaksinim, kujdes dentar, dhe kontrolle të syve). Në disa raste, personat që duhet të kujdesen për fëmijët në mungesë të prindërve të tyre, nuk i vënë re ose nuk iu përgjigjen problemeve të tyre shëndetësore. Në raste të tjera, këta persona nuk kanë të ardhura për t’u kujdesur për shëndetin e fëmijëve që iu janë lënë në përgjegjësi (p.sh gjyshërit që jetojnë me pagesën e pensionit).

Për fëmijët që ishin me prindërit e trafikuar, problemet shëndetësore fillimisht lidhen me kushtet e vështira të jetesës, kequshqyerjen, dhe ekspozimin ndaj dhunës kur trafikohen. Disa fëmijë kanë jetuar në shtëpi publike ose në shtëpi ku mamatë e tyre shfrytëzoheshin seksualisht, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të abuzimit, dhunës, dhe kërcënimeve.

Fëmijët e shfrytëzuar së bashku me prindërit e tyre kanë pësuar lëndime dhe sëmundje për shkak të trafikimit. Për shembull, fëmijët që janë detyruar të lypin janë ekspozuar ndaj elementeve, duke përfshirë nxehtësinë ose të ftohtët e tepërt, ndotjen dhe rrugët e pista. Fëmijëve që janë detyruar të punojnë me prindërit e tyre iu është mohuar gjumi i mjaftueshëm, uji i pastër, veshmbathjet e përshtatshme, higjiena bazë, ushqyerja e ekuilibruar, dhe ushqyerja e shëndetshme në marrëdhënie, të gjitha prej të cilave ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

Problemet më të zakonshme shëndetësore të fëmijëve të viktimave të trafikimit përfshijnë:

“ Kur u ktheva në shtëpi dhe takova djalin që e kisha lënë me prindërit e mi, ai filloi të qante. Ai më tha se disa ditë kishte pasur dhimbje dhëmbi, por askush nuk ia kishte vënë veshin. (Viktimë trafikimi që ka lënë një djalë në shtëpi)

”

“ Në ato ditë të vështira të jetës sime, e pashë vajzën e zverdhur. Ajo ishte lodhur dhe dobësuar. Nuk po e kuptoja se çfarë po ndodhte me të. Më vonë, ajo u diagnostikua me anemi. Jetesa në kushte të këqija dhe kequshqyerja i kishin krijuar anemi. (Viktimë trafikimi, e shfrytëzuar me vajzën e saj)

”

- Infeksione virale ose bakteriale të lidhura me kequshqyerjen, stresin kronik dhe një sistem imunitar të dobët.
- Skuqje lëkure dhe infeksione nga kushtet e papastra të jetesës
- Dhimbje dhe dëmtim dhëmbësh (duke përfshirë sëmundje të dhëmbëve dhe mishrave të dhëmbëve) për shkak të kujdesit të dobët dentar dhe/ose infeksioneve dentare
- Probleme me dëgjimin dhe infeksione për shkak të ekspozimit të pambrojtur ndaj zhurmave, infeksioneve ose lëndimeve
- Dhimbje koke, marramendje, çoroditje për shkak të lëndimeve ose shkaqeve sistemike (anemi e rëndë nga dieta e dobët, toksicitet në mjedis, si plumb në kushte të këqija të akomodimit)
- Kollitje, vështirësi në frymëmarrje, dhe dhimbje kraharori si pasojë e kushteve të papastra të jetesës
- Dobësim i sistemit imunitar, si pasojë e kequshqyerjes dhe stresit kronik
- Kapllëk, diarre, dhimbje abdominale dhe infeksione për shkak të kushteve të papastra të jetesës dhe cilësisë së ulët të ushqimit, kequshqyerjes dhe dehidratimit
- Mosmbajtje e urinës dhe lagje shtrati, të shkaktuara nga situata shumë stresuese

Disa fëmijëve u nevojitet referim për një shërbim mjekësor më të specializuar për të trajtuar lëndimet apo sëmundjet që kanë si rezultat i trafikimit.

Disa fëmijë kanë probleme shëndetësore si pasojë e zhvillimit të tyre në mitër ndërkohë që e ëma trafikohej. Kjo është një problematikë e ushqyerjes dhe kujdesit të pamjaftueshëm të mamasë për të mbështetur zhvillimin e shëndetshëm të foshnjës. Problematika të tjera shkaktohen nga përdorimi i substancave dhe dhuna dhe abuzimi mbi mamanë gjatë shtatzënisë. Fëmijët që lindin nga një situatë trafikimi mund të lindin para kohe dhe mund të vuajnë defekte në lindje, sindromën e alkoolit në fetus, dhe sindromën e përmbajtjes pas lindjes, ndër të tjera. Krahas kësaj, foshnjat mund të vuajnë nga sëmundjet dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme nga mamaja ose në mitër ose gjatë lindjes.

Në përgjithësi, fëmijët e viktimave të trafikimit kërkojnë akses në shërbimet e përgjithshme shëndetësore (vizita të rregullta te pediatri, kontrolle dhe vaksinime), që shpeshherë përbëjnë një kosto të vështirë për t'u mbuluar nga prindi i trafikuar. Ata duhet të zhvillojnë edhe aftësi për të mbrojtur shëndetin e tyre, duke ndjekur praktika të mira shëndetësore dhe higjienike.



{Pasi linda} fëmijën e mbajtën në inkubator, sepse ishte shumë i dobët. E pata shumë të vështirë kur u ktheva në shtëpi. Djali peshonte vetëm 1,200 gramë. Supozohej të ishte 2 kg përpara se të vinte në shtëpi, por ishte vetëm 1.2 kg. Nëse sëmuret tani, është edhe më e ndërlikuar, sepse ai është shumë i dobët. Duhet të kem gjithmonë barna për kollën dhe të ftohtët, sepse nëse sëmuret, dobësohet edhe më shumë. Kur ia laj rrobat, duhet të përdor zbutës, sepse i skuqet lëkura. Nuk mund të përdor sapun kur e laj. Është alergjik. (Viktimë e trafikimit femër, që është kthyer në shtëpi shtatzënë)¹⁴



Problematikat dhe nevojat shëndetësore

¹⁴ [Surtees, R. \(2017\)](#) 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 84.



“Alba” është trafikuar jashtë vendit për prostitucion, dhe u kthye në shtëpi shtatzënë. Ajo e lindi djalë para kohe. Djali peshonte më pak se 2 kg në lindje dhe tani që është pesë vjeç vuan nga një sërë problemesh shëndetësore.¹⁵

“Milena” ka abuzuar me alkoolin gjatë periudhës së trafikimit. Ajo mbeti shtatzënë gjatë asaj periudhe dhe vazhdoi të konsumonte alkool. Djali i saj, i cili lindi nga situata e trafikimit, ka vonesa të rënda zhvillimore si pasojë e abuzimit me substanca nga ana e të ëmës.¹⁶

“Katya” u trafikua për shfrytëzim seksual. Gjatë trafikimit, ajo mbeti shtatzënë, por u detyrua të vazhdonte të kryente marrëdhënie me klientët. Marrëdhëniet seksuale ishin të pambrojtura dhe ajo u infektua me sifiliz, si pasojë e shfrytëzimit seksual. Edhe fëmija i saj u infektua me sifiliz në mitër. Pasi lindi, si mamaja, ashtu edhe fëmija qëndruan në spital për trajtim, që zgjati për një kohë të gjatë.

“Genti” është një djalë 8-vjeçar që u trafikua së bashku me të ëmën. Ai u ekspozua ndaj dhunës dhe stresit në këtë periudhë. Tani ai vuan nga mosmbajtja e urinës dhe është vizituar te pediatri, por mjekimet nuk kanë qenë të efektshme. Episodet shpeshherë ndodhin kur Genti irritohet, frikësohet ose stresohet.

Problematikat dhe nevojat psikologjike

Viktimat e trafikimit vuajnë një sërë efektshëm psikologjike negative si pasojë e shfrytëzimit dhe trafikimit, dhe kërkojnë ndihmë psikologjike për rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.

“ Isha shumë e stresuar dhe ndihesha sikur nuk isha vetvetja. Mund të qëndroja në shtëpi për tri javë, pa dalë asnjë ditë, dhe nuk isha vetvetja. Edhe vetë motra ime më tha që dukeshja ndryshe. (Viktimë e trafikimit femër, që është kthyer në shtëpi me një foshnjë)¹⁷

”

“ Këta persona kanë shumë probleme dhe nuk arrijnë të kujdesen siç duhet për fëmijët e tyre. Ata shfaqin shumë herë sjellje agresive ndaj fëmijëve. Ne [shpeshherë shqetësohemi se] ajo

¹⁵ [Surtees, R. \(2017\)](#). 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 80

¹⁶ [Surtees, R. \(2017\)](#). 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 80

¹⁷ [Surtees, R. \(2017\)](#). 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 83.

Ata janë të ndjeshëm emocionalisht dhe shpeshherë iu mungon vetëbesimi. Shpeshherë e vënë në pikëpyetje identitetin, vlerat, dhe aftësitë e tyre për të kapërcyer vështirësitë. Shpeshherë ata e përkufizojnë veten nga ngjarjet që iu kanë ndodhur. Në fazat e hershme të rikuperimit, shumë viktimat janë të lodhura, të paduruara, të pashpresa, dhe nuk kanë interes apo aftësi të mësojnë gjëra të reja vetë.

mund ta dhunojë fëmijën nëse nuk jemi aty. Ata nuk mund të kujdesen për fëmijët. Ne [shpeshherë] e shohim situatën dhe e bën marrëdhënien midis tyre të vështirë. Këto nuk janë disa raste kur ndihen se nuk mund ta rrisin fëmijët... ka ardhur papritur dhe nuk janë në gjendjen e duhur për të rritur fëmijë. (Punonjës social)¹⁸



Shpeshherë, idetë e gabuara të viktimave për veten e tyre diktojnë sjelljet në jetë dhe në marrëdhënie me fëmijët e tyre. Përgjithësisht, ato nuk e dinë se si të menaxhojnë emocionet e tyre, ndaj stresi dhe mërzia shndërrohen në shpërthime inati dhe ata e përdorin dhunën kundër fëmijëve, si mjet disiplinimi. Pa aftësi të tyre për të menaxhuar emocionet mund të shpjerë edhe neglizhimin të fëmijëve.

Po ashtu, fëmijët e viktimave të trafikimit vuajnë psikologjikisht nga ajo që kanë kaluar ata dhe prindërit e tyre. Problemet dhe nevojat psikologjike ndryshojnë në varësi të faktit nëse fëmijët kanë qëndruar në shtëpi apo kanë qenë me prindërit e tyre gjatë trafikimit.

Fëmijët që kanë qëndruar në shtëpi gjatë trafikimit të prindërve të tyre vuajnë ndikime të ndryshme psikologjike. Atyre iu mungon prindi dhe ndjejnë vetmi, trishtim, dhe mall. Shpesh ata lëndon nga mungesa e prindërve të tyre dhe mungesa e kontaktit me ta gjatë trafikimit. Duke qenë se nuk janë në dijeni të faktit që prindërit e tyre po trafikohen dhe nuk mundën t'i kontaktojnë, këta fëmijë e shohin këtë mungesë si refuzim ose braktisje. Këto ndjesi përkeqësohen kur jetojnë me të afërm apo të tjerë, që nuk iu ofrojnë afekcion apo mbështetje emocionale, dhe mund të inatosen edhe me veten për atë që mendojnë se është neglizhimi apo braktisja nga prindi. Disa fëmijëve iu thuhet gjëra negative rreth prindit të tyre të trafikuar (p.sh “ajo të urren”, “ajo nuk të ka dashur kurrë”, “ajo është prostitutë”), që e përkeqëson edhe më shumë perceptimin e tyre negativ për ta.



Fëmijët e viktimave të trafikimit ndiejnë shumicën e kohës frikë, panik, vështirësi në krijimin e besimit dhe marrëdhënieve, dhe kanë vështirësi në menaxhimin e ndjenjave të stigmatizimit në komunitetin e tyre. Integrimi i tyre social është një sfidë (Punonjës social).

¹⁸ [Surtees, R. \(2017\)](#). 'What's home? [Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikimi], *Buletini për Gratë dhe Terapinë*. 40 (1-2), fq. 83.

Fëmijët e trafikuar së bashku me një prind janë të ekspozuar ndaj situatave shumë stresuese dhe traumatizuese si vëzhgues të shfrytëzimit të prindit të tyre, në ato raste kur ata shfrytëzohen së bashku me prindërit Shpesh, ata janë ekspozuar dhe kanë vuajtur dhunë nga trafikantët, si dhe persona të tjerë. Gjithashtu, zakonisht ata kanë qenë dëshmitarë të rregullt të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit që ka përjetuar prindi i tyre gjatë trafikimit.

”

Për shembull, një vajzë u mbaj të në një tën dhomë ku nëna e saj u shfrytëzua seksualisht, dhe rrjedhimisht u ekspozua ndaj përdhunimit që i bëhej vazhdimisht nënës së saj. Këta fëmijë përjetojnë shpesh depresion, ndjenja të të genit i pashpresë, faj, turp, vetëbesim të ulët, vetëvlerësim të ulët dhe ankth. Shpesh, ata shfaqin sjellje agresive ose izolohen nga shoqëria.

Fëmijët e lindur nga një përvojë trafikimi (qoftë të lindur gjatë trafikimit, apo pas trafikimit) mund të përballen me shumë probleme dhe ndikime. Për shembull, nuk është e pazakontë që nënat të mos lidhen menjëherë me fëmijën e vet, dhe atashimi mund të kërkojë pak kohë dhe mbështetje shumë intensive. Kjo mungesë ose vonesë atashimi ka ndikime shumë të tmerrshme dhe të thella në mirëqenien emocionale dhe psikologjike të fëmijës.

Atashimi (marrëdhënia emocionale ndërmjet foshnjës dhe nënës) është kyç për mënyrën se si truri i një foshnje e organizon veten, dhe se si fëmijët zhvillohen në aspektin social, emocional, intelektual dhe fizik. Atashimi i sigurt buron nga shkëmbimi emocional pa fjalë, që i bashkon të dyja palët, duke siguruar që fëmijë të ndihet mjaftueshëm i sigurt dhe i qetë për të përjetuar zhvillimin optimal të sistemit të vet nervor.

Atashimi i sigurt i ofron foshnjës themele të shëndosha në jetë: vullnetin për të mësuar, vetëdërgjegjësimin e shëndetshëm, besimin dhe konsideratën për të tjerët. Atashimi i pasigurt, që nuk plotëson nevojën e foshnjës për siguri dhe mirëkuptim, mund të sjellë hutim mbi identitetin e vet dhe vështirësi për të nxënë dhe për t'u lidhur me të tjerët.

Mbështetja e grave dhe e pjesëtarëve të familjeve të tyre për ta pranuar fëmijën është shpesh kyçi në pranimin e fëmijës, atashimin e nënës dhe mirëqenien psikologjike afatgjatë të fëmijës.

Fëmijët e lindur pas përfundimit të trafikimit mund të jetojnë në mjedise stresuese (për shembull, në

“ Kur marrim një psikolog për këta fëmijë dhe [psikologu] vëren se ndonjëherë është shumë e vështirë për ta [të këshillohen], të jenë të hapur për të folur, të ndërveprojnë me të tjerët. [Fëmijët] ndihen më të izoluar ose ndonjëherë ka sjellje më shumë agresive, për shkak të këtyre frustimeve dhe të gjithçkaje që kanë parë (Punonjës social)¹⁹

”

“ Në atë kohë nuk doja të kisha fëmijë, dhe jo më të sillja një jetë në atë formë. Nuk doja ta mbaja foshnjën, por kushtet më detyruan që ta çoja deri në fund shtatzëninë. Në fillim, mendova ta jepja për adoptim. Kisha një problem kur i afrohesha, nuk mund ta puthja ose të kujdesesha për të. I thashë vetes se nuk duhet të ndodhte kështu. Na u desh pak kohë për ta pranuar njëra-tjetrën, të dyjave. Mesa duket, ajo e ka kuptuar që nuk e dëshiroja/doja. Foshnja ime dhe unë mësuam të rriteshim bashkë, ajo ishte fëmija im. Zoti e solli në jetë dhe unë e pranova si shoqen time të jetës. Mësova ta doja fëmijën tim pa kushte, mësova të kujdesesha për të dhe jam e lumtur që e kam. (Femër, viktimë e trafikimit)

”

¹⁹ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 95.

një strehëz ose në mjediset familjare dhe komunitare stresuese), që ka një ndikim psikologjik dhe emocional tek ata. Të porsalindurit dhe nënat e tyre, madje edhe në mjediset më konstruktive të strehëzës, nuk mund t'i shmangin disa rrethana që krijojnë stres dhe ankth për fëmijët, si ndarja e mjedisit me përfitues të tjerë, niveli i zhurmës që vjen nga aktivitetet e përditshme ose ndërhyrjet në amësinë e tyre nga banorët e tjerë dhe vetë stafi. Mund të lindin edhe probleme të ngjashme kur fëmijët jetojnë me nënat e tyre në një mjedis më të gjerë familjar që nuk është mbështetës për nënën dhe/ose fëmijën.

“ Ajo kujdeset [për foshnjën 1 vjeç]. Ajo e përqafton, e ushqen dhe e mban në krah, e mban të pastër. Por, kur është e stresuar ose kërkon vëmendje të veçantë, e abuzon duke i thënë: “I ke ngjarë tët eti”. (Punonjës social)²⁰ ”

Në të gjitha rrethanat, fëmijët përballen me probleme shtesë pas përfundimit të trafikimit për shkak të gjendjes psikologjike të prindit të tyre të trafikuar. Stresi dhe ndjenjat negative janë shpesh të shumta dhe të vështira për t'u kontrolluar nga prindërit e trafikuar. Disa prindër nuk kanë zhvilluar aftësi për t'u përballur me fëmijët e tyre në mënyrën e të mirë të mundshme. Një prind i trafikuar mund të jetë shumë protektiv për shkak të frikës dhe ankthit se çfarë kanë përjetuar, dhe shqetësohen se kjo mund t'iu ndodhë edhe fëmijëve të tyre. Kjo mund të shkaktojë tension në marrëdhënien ndërmjet prindit dhe fëmijës, e cila, në adoleshencë, mund të shprehet nëpërmjet të qenit i tërhequr ose rebelimit. Për rrjedhojë, mbështetja për prindërimin është një pjesë përbërëse e procesit të riintegrit, duke përfshirë se si t'ia dalësh si prind, cilat janë sjelljet e shëndetshme të prindërimit, trajnimi për disiplinimin pozitiv, se si të çlirojnë stresin prindëror, se si të zhvillojnë aftësitë e ofrimit të kujdesit, teknikat e menaxhimit të stresit dhe inatit, dhe aftësitë jetësore dhe të prindërimit.

Fëmijët e viktimave të trafikimit kanë nevojë për dashuri dhe pranim nga prindi i tyre, si dhe mbështetje dhe dashuri të pakushtëzuar. Ata kanë nevojë për udhëzime se si të krijojnë marrëdhënie dhe mënyra ndërveprimi të shëndetshme, duke përfshirë kufij të shëndetshëm të mjedisit. Fëmijët mësojnë nga prindërit e tyre dhe të tjerët për modelimin e këtyre sjelljeve. Ata duhet të monitorohen nga afër për të identifikuar shenjat e stresit emocional, dhe të përpiqen dhe të marrin ndihmë për të menaxhuar stresin dhe vështirësitë. Atyre duhet t'iu mësohet se si të kontrollojnë emocionet dhe sjelljet e tyre, pasi në përgjithësi kjo nuk është diçka që e kanë mësuar ose modeluar nga prindi i tyre.

Problemet dhe nevojat psikologjike

Bora” u abuzua nga njerku i saj në moshë të hershme dhe, për më tepër, ishte dëshmitare kur nëna e saj shfrytëzohej seksualisht nga njerku i saj, i cili e detyronte të kryente marrëdhënie seksuale me burra që ai i sillte në shtëpi. Bora u rrit në një mjedis të pashëndetshëm dhe u ekspozua ndaj shumë ngjarjeve të frikshme. Ajo ka parë nënën e saj teksa abuzohej dhe kryente marrëdhënie seksuale në të njëjtën dhomë ku ajo flinte. Bora vuajti edhe abuzimin dhe përdhunimin nga shumë burra me të cilët ajo kishte patur marrëdhënie. Ajo e pranoi abuzimin si fakt në jetën e saj dhe nuk ishte në gjendje ta mbronte veten. Ajo u rrit me abuzimin seksual dhe kjo e bëri atë të ndihej edhe më e pafuqishme për të dalë nga ky rrjet. Bora u trafikua më vonë për shfrytëzim seksual.

“Era” u trafikua për shfrytëzim seksual dhe përfundoi shtatzënë nga trafikimi. Fëmija i saj u lind nga trafikimi dhe ajo përshkroi se si vuajti në fillim për t'u lidhur me të, dhe shpjegoi se

²⁰ Surtees, R. (2017) ‘What’s home? (Re)integrating children born of trafficking’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), p. 83.

mbështetja psikologjike ishte jetike për ta pranuar dhe dashur fëmijët e saj: “Mësova se asgjë, dhe sigurisht asnjë burrë, nuk mund të shkatërrojë forcën dhe dashurinë [që kam] për fëmijën tim. E di se nëse do e kisha mbajtur përbrenda do të kishte qenë sigurisht shkatërruese.”

“Hëna” është 15 vjeç. Ajo u rrit nga nëna e saj, e cila u trafikua për shfrytëzim seksual dhe ishte me të gjatë kohës që ndodhi kjo. Pas trafikimit, për një periudhë kohe ajo jetoi me nënën e saj në një strehëz. Është një marrëdhënie e vështirë vajzë-nënë, pasi nuk ishte gjithmonë e qartë se kush ishte prindi përgjegjës për t’u kujdesur për tjetrin. Nëna e Hënës nuk vendosi kufij prindërorë për të, çka e hutoi fëmijën. Ajo u rrit në një mjedis jo të këndshëm dhe të pashëndetshëm, në të cilin nuk ndihej e sigurt dhe e dashur pa kushte. Hëna nuk ka marrëdhënie të mira me nënën ose babanë e saj, dhe kjo ka ndikuar në mënyra se si ajo krijon dhe menaxhon marrëdhëniet me të tjerët. Ajo ka marrë rregullisht vendime në marrëdhënie që kanë shkaktuar probleme, ose që kanë çuar në situata të rrezikshme.



Problemet dhe nevojat ekonomike

Shumica e viktimave të trafikimit vijnë nga situata ekonomike të vështira dhe emigrojnë sepse iu duhet të fitojnë para. Ky është rasti i prindërve që emigrojnë për të mbështetur dhe rritur fëmijët e tyre. Më pas, situata e tyre ekonomike përkeqësohet nga trafikimi, pasi në përgjithësi e kanë të pamundur të fitojnë dhe dërgojnë para për t'u kujdesur për familjen e tyre.

Fëmijët e mbetur pas janë shpesh të privuar materialisht në mungesë të prindit të tyre të trafikuar, duke pasur parasysh se nuk janë në gjendje të dërgojnë para në shtëpi. Problemet financiare ishin një burim stresi dhe tensioni me familjet e mbetura pas, të cilat kishin marrë përsipër kujdesin dhe mbështetjen financiare të fëmijës.

Të afërmit nën kujdesin e të cilëve janë lënë këta fëmijë (gjyshërit, hallat/tezet, xhaxhallarët/dajat) mbështeten shpesh te remitancat nga prindi emigrant për t'u kujdesur për fëmijët. Kur nuk ka remitanca, fëmijët nuk do të marrin kujdesin e duhur (nuk do të ushqehen, vishen dhe nuk do të marrin kujdesin e duhur, nuk do të kenë akses në kujdesin mjekësor), ose do të braktisin shkollën dhe, në rast të fëmijëve më të mëdhenj, do të gjejnë punë për të kontribuar në ekonominë e familjes.

Kthimi në shtëpi pa para dhe me një fëmijë ishte një përgjegjësi e jashtëzakonshme financiare, dhe prindërit e trafikuar shpesh kanë vështirësi për t'i mbështetur fëmijët e tyre financiarisht, për t'i ushqyer dhe për t'i veshur. Kjo mund të jetë burim i një stresi dhe frustrimi të madh për prindërit që kanë vështirësi. Ata kanë vështirësi për të paguar strehimin, shkollimin dhe materialet shkollore, dhe kujdesin mjekësor. Disa fëmijëve iu është dashur të linin shkollën sepse prindërit e tyre nuk mund të përballonin tarifat e shkollimit ose kostot e tjera arsimore. Në disa raste, këta fëmijë duhet të punojnë për të kontribuar në ekonominë e familjes.

“ Prindërit nuk ishin vërtetë të lumtur të më shihnin. Ndodhi që u ktheva [nga jashtë vendit] pa para (Femër, viktimë e trafikimit).²¹ ”

“ Fëmijë kërkojnë para, ata duan para në shkollë. Ata nuk pyesin nëse ke, ata thjesht thonë që duan para... [Te puna ime] ka mungesë stafi, kështu që kam punuar [shumë] dhe gjatë kësaj periudhe kishte një [dramë në shkollë]. Vajza më pyeti: “Përse nuk erdhe, sepse të gjitha nënat erdhën”, dhe u isha gati të qaja pasi më erdhi shumë keq që nuk mund të shkoja në performancë. Duhet të punoj sepse duhet të mbaj familjen. [Pronari] dyfishoi qiranë dhe më duhej të mbijetoja disi. (Grua e trafikuar, nënë e tre fëmijëve) ”

“ Ky është momenti kur vjen frustrimi. [Ata mendojnë] “Oh Zot... Nuk di se si të ushqej fëmijët e mi. Nuk di çfarë të bëj.” (Punonjësi social)²² ”

²¹ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 89.

²² Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 84.

Për rrjedhojë, problemet ekonomike kanë me gjasë ndikime serioze dhe afatgjata për viktimat e trafikimit dhe fëmijët e tyre. Këto presione financiare mund të krijojnë ose përkeqësojnë tensionet në familjet e viktimave.

Disa viktimat të kthyer përballen me akuza nga prindërit ose të afërmit me të cilët i kanë lënë fëmijët e tyre dhe që iu është dashur të marrin përsipër përgjegjësinë për t'u kujdesur për këta fëmijë në mungesë të prindit të trafikuar.

Prindërit e trafikuar kanë nevojë për asistencë për të gjetur punë që të jenë në gjendje të mbështesin fëmijët e tyre. Këtu mund të përfshihet formimi profesional, si dhe asistencë në regjistrimin si punëkërkuar në zyrën e punësimit, dhe asistencë në kërkimin e punës deri në punësimin e tyre përfundimtar.

Është një sfidë mjaft e madhe kur viktimat e trafikimit nuk kanë përfunduar ose ndonjëherë nuk kanë ndjekur shkollën, dhe nuk kanë përvojë pune të konsiderueshme. Një tjetër ndërlikim është se shumë viktimat po përballen me ndikimin e trafikimit të tyre dhe mund të mos jenë gati për tregun e punës.

Ato kanë nevojë për mbështetje lidhur me kujdesin për fëmijën gjatë orëve të punës, pas orëve të shkollës dhe gjatë natës, kur punojnë me turne. Kjo është mjaft e ngutshme në rastin e nënave të vetme që nuk kanë rrjet mbështetjeje për t'u kujdesur për fëmijët e tyre në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, ndërkohë që ato punojnë.

Në rastin e adoleshenteve, ata kanë nevojë si për punësim, formim profesional, si dhe mbështetje për të mbajtur një punë.

Fëmijët në këtë moshë kanë nevojë për mbështetje gjatë tranzicionit në pavarësi që ndodh gjatë adoleshencës, duke përfshirë zhvillimin e tyre personal, formimin në të ardhmen dhe zhvillimin e karrierës.

”

“ **U bërë barrë për familjen time dhe fëmijët e tu janë barrë për familjen tonë... Më ka ardhur në majë të hundës duke ushqyer fëmijët e tu. (Nënë e një viktime trafikimi të kthyer që kujdesej për nipërit/mbesat e saj në mungesë të nënës së tyre)²³**

”

“ **Ndihem shumë e qetë në punë, kur e di se ata po kujdesen mirë për djalin dhe se ai është në një mjedis të sigurt, me ushqim të mirë dhe shumë lodra. (Femër, viktimë e trafikimit dhe nënë e një djali)**

”

“ **Nuk kisha askënd me të cilin mund t'i lija fëmijët dhe rrjedhimisht ishte e pamundur që të gjeja një punë. Tani që fëmijët vijnë te Shtëpia e Gjyshes (programi i kujdesit për fëmijën), unë po punoj më e qetë nga e hëna në të shtunë, dhe situata ime ekonomike po përmirësohet. (Femër, viktimë e trafikimit dhe nënë e dy fëmijëve)**

”

“ **Tani që dy fëmijët e mi po ndjekin [programin e kujdesit për fëmijën], kam gjetur një punë që më pëlqen, por punoj me orë të gjata. (Femër, viktimë e trafikimit dhe nënë e dy fëmijëve të vegjël)**

”

²³ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 89.

Është e rëndësishme që ata të angazhohen edhe në aktivitete të tjera, si në sporte dhe zhvillimin e hobit. Adoleshentët mund të angazhohen në punë që janë të përshtatshme për moshën e tyre, me kohë të pjesshme (deri në katër orë në ditë), me kushtin që orët e punës të mos ndërhyjnë në frekuentimin e shkollës dhe të zhvillohen me pëlqimin e prindit/kujdestarit të tyre ligjor. Shërbimet e fëmijëve shpesh e drejtojnë vëmendjen drejt fëmijëve me të vegjël, por është e rëndësishme që të mos që të mos anashkalohen dhe femijet më të rritur.

Problemet dhe nevojat ekonomike

“Dola” është një viktimë e trafikimit dhe nënë e vetme e dy vajzave të vogla. Ajo jeton në kryeqytet dhe nuk ka afër asnjë familjar të cilit mund t’i besonte mbajtjen e fëmijës teksa punon. Kjo ia vështirësoi shumë gjetjen e punës dhe përqendrimin në punën e saj. Megjithatë, kur e kishte të mundur të aksesonte një program kujdesi për fëmijën ku vajzat mund të qëndronin gjatë orëve të saj të punës, ishte një kontribut i rëndësishëm për mirëqenien e të gjithëve:

“Vajzat ndihen shumë mirë te Shtëpia e Gjyshes (programi kujdesi për fëmijët), dhe janë entuziaste, pasi iu pëlqen ushqimi dhe lodrat. Tani jam e qetë kur punoj.”

“Ela” është 16 vjeç. Nëna e saj u shfrytëzua seksualisht jashtë vendit dhe u kthye pas dy vitesh. Shpesh, Ela është detyruar nga nëna e saj që të kontribuonte në të ardhurat e familjes. Ajo e frekuenton shkollën, por pas shkollës punon në një supermarket, ku sistemon mallrat. Ajo ka vështirësi për të balancuar përgjegjësitë e veta, për të frekuentuar shkollën rregullisht, për të marrë nota të mira dhe për të kontribuar në të ardhurat e familjes.

“Melita” është një viktimë e trafikimit dhe nënë e vetme e një djali të vogël. Kur u kthye nga jashtë vendit, familja e saj nuk e mbështeti. Ajo ishte vetëm, pa punë dhe me shumë shpenzime. Ajo ndoqi një kurs formimi profesional, por kishte shumë vështirësi sepse duhej të kujdesej për fëmijën e saj. Pas përfundimit të kursit, ajo u mbështet për të hapur një biznes të vogël dhe për të punuar nga shtëpia. Ky ishte një çlirim i madh për të pasi tani mund të punonte dhe të kujdesej për djalin e vogël.



Problemet dhe nevojat për arsimim dhe formim

Disa fëmijë të mbetur pas mund të jenë përballur me probleme për të vazhduar arsimin e tyre. Kur fëmijët lihen me gjyshërit ose të afërm të tjerë, ata jo gjithmonë e ndjekin rregullisht shkollën, pasi gjyshërit nuk janë në gjendje t'i shoqërojnë fëmijët në shkollë ose të ndjekin progresin e tyre në mësim. Ata shpesh nuk janë në gjendje të ofrojnë ndihmë për detyrat e shtëpisë dhe të nxënës.

Fëmijëve, prindërit e të cilëve kanë qenë të trafikuar, mund t'iu mungojë motivimi për të studiuar ose mund të mos marrin mbështetjen që kanë nevojë për të studiuar dhe mësuar. Në disa raste, fëmijët e mbetur pas nuk janë në gjendje të vazhdojnë shkollimin për shkak të tarifave të shkollimit, materialeve mësimore dhe transportit. Edhe fëmijët e mëdhenj e lënë shkollën për të punuar dhe fituar para për familjen.

Në përgjithësi, fëmijët e trafikuar me një prind ose të lindur nga trafikimi nuk e kanë ndjekur shkollën teksa kanë qenë larg. Ata mund të mos e kenë ndjekur kurrë shkollimin formal ose mund të mos kenë fare aftësi për shkrim dhe lexim, dhe për numrat. Kur ata hyjnë në arsimin formal, mund ta kenë të vështirë, pasi ata zakonisht janë më të mëdhenj në moshë se nxënësit e tjerë. Ata mund të mos flasin gjuhën e tyre amtare ose mund ta flasin nën nivelin e duhur për moshën dhe klasën e tyre.

Fëmijët e viktimave të trafikimit kanë edhe nevoja të tjera arsimore gjatë rikuperimit dhe riintegrit të tyre. Këta fëmijë janë rritur në situata jashtëzakonisht të vështira dhe jo gjithmonë i kanë zhvilluar aftësitë jetësore bazë. Për rrjedhojë, pjesë e arsimimit të tyre është zhvillimi i aftësive jetësore, si: higjiena personale, aftësitë e komunikimit, kujdesi për trupin, larja dhe veshja, të mësuarit e sjelljeve të shëndetshme, të mendimit kritik dhe aftësi komunikuese. Prindërit e trafikuar gjithashtu përfitojnë nga programet e aftësive për jetën dhe prindërimin për t'i ndihmuar ata të mësojnë sjellje pozitive dhe sesi të çlirojnë stresin e tyre (për shembull teknika të prindërimit pozitiv, teknika të menaxhimit të stresit dhe inatit, si dhe aftësi personale për jetën.

Arsimimi për fëmijët e vegjël (mosha parashkollore) mundësohet nëpërmjet alternativave të ndryshme të kujdesit ditor (për shembull çerdhe, kopshte dhe qendra kujdesi pas shkolle). Programet e kujdesit për fëmijët ofrojnë një mjedis ku fëmijët përfitojnë kujdes, hanë ushqime të shëndetshme, mësojnë dhe luajnë e ndërveprojnë në mënyrë konstruktive me fëmijët e tjerë. Shumë prindër të trafikuar kanë nevojë për të punuar dhe fituar para për familjet e tyre, por janë zakonisht larg familjes dhe e kanë të pamundur për t'u kujdesur për fëmijët e tyre teksa punojnë. Prindërit që punojnë me turne ose me orare jo të rregullta përballen shpesh me vështirësi për të

“ Do më pëlqente më shumë shkolla e vjetër. Tani nuk kam shokë. Kjo e reja është pak larg nga shtëpia. Nuk kam shokë me të cilët të luaj. Nuk më pëlqen shkolla. (Fëmijë tetë vjeç i një viktime trafikimi)

”

“ Kam mbaruar klasën e shtatë, më pëlqente shkolla, ëndërroja të bëhesha mësues. Por, jeta u bë e vështirë dhe nuk munda ta përfundoj. Më vjen keq për fëmijët e mi që po hasin vështirësi për të ndjekur shkollën. (Viktimë e trafikimit me dy fëmijë të vegjël)

”

“ Rekomandohet që programi i fëmijëve të viktimave të trafikimit të përqendrohet te zhvillimi i fëmijës dhe mësimi i vlerave dhe aftësive, si: të dëgjuarit, të ndarit, përgjegjësia për veten, ndërveprimi në grup dhe aftësitë e kujtesës. (Punonjës social)

”

pasur akses në programe të kujdesit për fëmijët që përputhen me orarin e tyre të punës. Ata kanë nevojë për alternativa të kujdesit për fëmijët, në të cilat fëmijët mund të përfitojnë kujdes, si për shembull pas orarit të shkollës, gjatë natës dhe/ose gjatë fundjavave.

Fëmijë të tjerë mund të kenë nevojë edhe për formim profesional për të përvetësuar njohuri profesionale dhe për të gjetur punë. Formimi profesional është një element i rëndësishëm i riintegrit të fëmijëve, pasi ndihmon për të rritur shanset e punësimit fitimprurës, për të qenë më i pranueshëm për punësim në tregun e punës, tani dhe në të ardhmen, si dhe për të rritur vetëbesimin dhe aftësitë e përgjithshme jetësore.

“ Dikur vajza ime ishte shumë e turpshme dhe nuk fliste. Tani që shkon në kopsht ka filluar të flasë dhe të ndërveprojë me fëmijët e tjerë. Jam shumë e lumtur teksa e shoh atë çdo ditë që mezi pret të vijë këtu. Tani punoj e qetë dhe ndihem shumë mirë. (Femër, viktimë e trafikimit dhe nënë e një vajze)

”

Në varësi të moshës së tyre, fëmijët duhet të nxiten për të vendosur qëllime punësimi realiste që përkojnë me aftësitë dhe shprehjet e tyre, nivelin arsimor, dhe mundësitë e përshtatshme për punësim në vendndodhjen e tyre. Duhet të bëhen përpjekje për të ofruar formimin e nevojshëm profesional për t'i realizuar këto qëllime.

Problemet dhe nevojat për arsimim dhe formim

Ndërsa “Lola” ishte jashtë vendit, ajo e la vajzën e saj “Sara” me prindërit e saj që do të kujdeseshin për të. Prindërit e saj jetonin në një fshat ku nuk kishte shkolla. Sara duhej të ecte tridhjetë minuta për të arritur në shkollën më të afërt. Në fillim, Sara e frekuentonte çdo ditë shkollën, por ishte e vështirë për të përshkruar distancën. Dhe kishte vështirësi me orët e mësimi dhe nuk kishte mbështetje në shtëpi për të nxënit. Ajo nuk kishte mbështetje në shtëpi nga gjyshërit për ta ndihmuar me mësimet dhe ishte e frustruar nga shkolla. Sara, përfundimisht, vendosi ta braktiste shkollën. Kur Lola u kthye në shtëpi, mësoi se vajza e saj nuk ishte në shkollë dhe kishte mbetur pas shokëve në arsimim.

“Bela” është një viktimë e trafikimit dhe nënë e vetme e dy fëmijëve të vegjël. Ajo punon me orë të gjata dhe shpesh arrin vonë në shtëpi. Fëmijët e saj ndjekin një programi kujdesi për fëmijët teksa ajo punon, pasi atyre iu ofrohet kujdes fizik (ushqehen dhe lahen) dhe ndihmohen me mësimet e tyre: “Kthehem vonë në shtëpi, por jam e lumtur sepse fëmijët janë ushqyer, janë të pastër dhe djali më i madh që ndjek shkollën i ka mbaruar detyrat e shtëpisë me ndihmën e mësuesve”.



Problemet dhe nevojat ligjore

Për prindërit e trafikuar dhe fëmijët e tyre mund të lindin shumë probleme ligjore. Disa mund të lidhen me trafikimin e personave, ndërsa të tjerat me probleme më të përgjithshme që lindin gjatë riintegritimit. Problemet ligjore kyç përfshijnë:

- **Caktimin e një kujdestari ligjor në rastin e fëmijëve prindërit e trafikuar të të cilit e kanë të pamundur të kujdesen për ta.** Fëmijët vendosen në kujdestarinë e një kujdestari ligjor kur prindërit e tyre e kanë të pamundur të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, sepse të dy prindërit kanë vdekur ose nuk dihen, janë shpallur të humbur, iu është hequr përgjegjësia prindërore ose prindërve iu është privuar mundësia për të vepruar, dhe për arsye të tjera të pranuar nga gjykata.

“Vendosa ta lija fëmijën në një institucion të kujdesit për fëmijët dhe përgatita një dokument ku deklarova se doja dhe isha plotësisht dakord dhe dhashë pëlqimin që fëmija im të transferohej për të jetuar në një institucion të tillë, sepse nuk kam mundësi të kujdesem për të. (Femër, viktimë e trafikimit)

”

- **Braktisjen e një fëmije të lindur nga një situatë trafikimi.** Disa viktima të trafikimit nuk janë në gjendje të kujdesen për fëmijën e tyre ose të lidhen me të. Ata e lënë fëmijën në një institucion ose e lënë në kujdesin e ndonjë të afërmi. Kujdestarinë e fëmijës, i cili nuk ka të afërm që dihen ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, gjykata mund t'i kalojë një institucioni publik ose privat të licensuar për kujdesin për fëmijët. Drejtori i institucionit i delegon njërit prej punonjësve të vet të drejtën për të ushtruar funksionet e kujdestarit të fëmijës.
- **Caktimin e atësisë në rastin e fëmijëve të lindur gjatë ose pas trafikimit.** Disa gra ishin shtatzëna kur u trafikuan dhe i lindën fëmijët gjatë trafikimit. Jo në të gjitha rastet babai e njeh atësinë e atij fëmije, duke pretenduar se fëmija është lindur gjatë trafikimit. Kjo ka një ndikim negativ te fëmijët që nuk krijojnë një marrëdhënie me babanë e tyre dhe për të gjithë familjen në tërësi, e cila, zakonisht, prishet si rezultat i situatës. Nënata e trafikuar kërkojnë mbështetje në lidhje me përcaktimin e atësisë së fëmijës, si dhe mbështetje për fëmijën.
- **Divorcin kur një viktimë trafikimi kthehet në shtëpi.** Shumë martesë dështojnë si rrjedhojë e ndarjeve gjatë trafikimit. Ky është zakonisht rasti kur gratë janë trafikuar për shfrytëzim seksual dhe bashkëshortët e tyre nuk mund ta pranojnë atë që ka ndodhur. Situata përkeqësohet më tej kur një grua kthehet në shtëpi shtatzënë ose me një fëmijë të lindur nga një situatë trafikimi. Prindërit e trafikuar kërkojnë ndihmë ligjore për procedurat e divorcit, duke përfshirë kujdestarinë e fëmijëve.
- **Kujdestarinë dhe aksesin e fëmijës.** Disa gra të trafikuar janë të privuara nga kontakti me fëmijët që kanë mbetur pas kur ato kanë emigruar. Zakonisht, bashkëshorti (me të cilin janë

divorcuar më parë ose prej kohësh) ka kujdestarinë dhe nuk i lejon ata t'iu afrohen fëmijëve të tyre, dhe madje mund të nxijnë imazhin dhe opinionet e fëmijëve për nënat e tyre (p.sh., e akuzojnë si prostitutë, se i ka braktisur), në mënyrë që fëmijët të mos kenë dëshirë t'i shohin nënat e tyre. Prindërit e trafikuar kërkojnë asistencë ligjore për të fituar aksesin dhe në disa raste edhe kujdestarinë e fëmijës.

Problemet dhe nevojat ligjore²⁴

“Linda” mbeti shtatzënë kur u trafikua. Pasi ajo shpëtoi nga trafikimi, punonjësi social punoi me të për të shqyrtuar alternativat e ndryshme të saj. Ajo vendosi ta lindte foshnjën, por do ta jepte për adoptim. Punonjësi social punoi me të që ajo ta kuptonte dhe të përgatitej për procesin e adoptimit, në aspektin ligjor dhe psikologjik. Dy ditë pas lindjes së fëmijës, punonjësi social në maternitet e ndihmoi Lindën për të përgatitur dhe përpunuar të gjitha dokumentet e nevojshme për adoptimin e fëmijës. Linda u mbështet dhe u shoqërua për të përgatitur të gjitha dokumentet dhe për të bërë deklaratën për kujdestarinë e fëmijës.

“Desi” ishte viktimë e trafikimit për shfrytëzim seksual. Fëmijët e saj lindën si rrjedhojë e situatës së saj të trafikimit, dhe më vonë mbetën pas nën kujdesin e nënës së saj. Pasi ajo u arratis nga situata e saj e trafikimit, ajo u akomodua në strehëz së bashku me tre fëmijët e saj. Ajo ishte thellësisht e traumatizuar nga përvoja e saj e trafikimit dhe vuante nga probleme të shëndetit mendor. Ajo tentoi vetëvrasjen, pas së cilës u shtrua në spitalin psikiatrik për tre javë, siç rekomandoi edhe mjeku psikiatër. Duke pasur parasysh situatën dhe nevojat e saj, gjykata vendosi që kujdestaria e përkohshme për tre fëmijët e saj t'i kalonte nënës së saj, pra gjyshes së tyre, derisa ajo të ishte në gjendje të kujdesej për ta.

“Tina” u akomodua së bashku me fëmijën e saj në strehëz. Megjithatë, në planin afatgjatë ajo nuk ishte në gjendje ta mbante dhe të kujdesej për djalin e saj, dhe gjykoi se do të ishte më mirë që ai të qëndronte në një nga institucionet e rritjes dhe arsimimit. Rrjedhimisht, fëmija i saj u sistemua përkohësisht në jetimore me vendim të Shërbimit Social Shtetëror. Tina u asistua për trajtimin e të gjitha kërkesave ligjore dhe administrative për vendosjen e fëmijës në jetimore.

“Lara” u trafikua jashtë vendit për shfrytëzim seksual dhe burri i saj vendosi që ajo të ishte bashkëshortja e tij. Ajo lindi fëmijën e tij dhe po e rriste vajzën duke jetuar me të. Ai ishte jashtëzakonisht i dhunshëm dhe e rriste rregullisht. Ajo u arratis dhe u njoh si viktimë e trafikimit, dhe u asistua në një strehëz në vendin e destinacionit. Megjithatë, ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në shtëpi pasi nuk kishte kujdestarinë ligjore të fëmijës së saj, dhe fëmija nuk kishte dokumente ligjore ose nuk ishte regjistruar në vendin e saj të origjinës. Përkundrazi, ajo u detyrua të përfshihej në një betejë për kujdestarinë me babanë e vajzës së saj dhe me trafikantin e vet, duke shpresuar se do ta sillte vajzën në vendlindje për të jetuar. Asaj i duhej jo vetëm që të fitonte betejën për kujdestarinë, por edhe të kishte akses në dokumentet ligjore.

²⁴ Surtees, R. (2017) *Duke dëgjuar viktimat: Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindor*. Vjenë: ICMPD & Instituti NEXUS.



Problemet dhe nevojat administrative

Disa fëmijë viktima të trafikimit nuk janë regjistruar në lindje. Kur lihen pas nga prindi emigrant, fëmijët nuk kanë status ligjor, iu mungojnë gëzimi i të drejtave bazë dhe shërbimeve si arsimit dhe kujdesi shëndetësor.

“ Problemi është se nuk mund të sqaroj asgjë pa pasur dokumente dhe nuk mund të nxjerr një certifikatë lindjeje për fëmijën tim... Kudo që shkoja më thoshin se nuk mund të më ndihmonin. Nuk mund ta bëja këtë e vetme. (Femër, viktimë e trafikimit)²⁵

”

“ Një fëmijë kishte një certifikatë të lëshuar nga spitali ku fëmija u lind. Një tjetër fëmijë nuk kishte asgjë. Këtë rast të parë mund ta trajtojmë si rast fatlum, sepse kjo [nënë e trafikuar] ia doli të arratisë dhe e kishte foshnjën në maternitet, dhe falë një avokati ne morën certifikatën e lindjes nga materniteti. Po në rastin e grave që nuk lindin në spital, por në vendin ku ndodhen? (Punonjës social)²⁶

”

“ Ajo është shumë e fortë, fizikisht dhe shpirtërisht. Ajo ka një familje të mirë që e pranoi të kthehej në shtëpi, dhe problemi i saj kryesor janë dokumentet për fëmijën e saj. Këtu kemi një seri procedurash të veçanta për ta përgatitur këtë dokument” (Punonjës social)²⁷

²⁵ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 94.

²⁶ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 93.

²⁷ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 94.

Fëmijët e trafikuar së bashku me një prind që i mungon statusi ligjor mund të përballen me vështirësi themelore për t'u kthyer në

vendlindje, si dhe për të pasur akses në shërbime të nevojshme për të mbështetur rikuperimin dhe riintegrimin e tyre. Regjistrimi në lindje është një problematikë për fëmijët e lindur gjatë trafikimit, të cilët mund të mos jenë regjistruar kurrë në lindje dhe, për më tepër, mund të mos kenë statusin/identitetin ligjor në vendin e origjinës së nënës së tyre.

Disa fëmijë të lindur nga nëna të trafikuar jashtë vendit janë regjistruar ligjërisht në lindje në vendin e destinacionit (p.sh. në spitalin ku janë lindur), që do të thotë se kishin identitet ligjor.

Fëmijët e tjerë janë lindur “jozyrtarisht” (pra jo në spital apo klinikë) dhe nuk kishin dokumente regjistrimi të lindjes së tyre dhe, rrjedhimisht, as identitet ligjor. Kjo e bëri sfidues lëshimin e dokumenteve për kthimin në shtëpi, si dhe regjistrimin me mbërritjen në shtëpi. Po ashtu, kjo kufizon aksesin e tyre në shërbimet dhe të drejtat më bazë me kthimin në shtëpi, gjë që ka sjellë pasoja për riintegrimin e tyre.

Disa nëna të trafikuar nuk ishin as vetë të regjistruara, që do të thotë se e kanë të pamundur të kenë akses në shërbime urgjente në shtëpi kur kthehen teksa janë shtatzëna (për shembull, kujdes mjekësor para lindjes), ose për të regjistruar fëmijën e tyre derisa të zgjidhet statusi i tyre ligjor.

Fëmijët e lindur pas kthimit të nënës së tyre në shtëpi kanë më shumë gjasa të regjistrohen ligjërisht dhe të kenë dokumente ligjore. Megjithatë, mund të lindin edhe probleme për aksesin në shërbime lidhur me faktin se ku është regjistruar dikush (p.sh. fshati) kundrejt fakti se ku i aksesojnë shërbimet (p.sh. ku zhvillohen programet e riintegrit, komuniteti i ri i integrit). Disa viktimë të trafikimit dhe fëmijët e tyre përballen me pengesa administrative në këtë proces.

Transferimi i gjendjes civile të dikujt nga vendi i regjistrimit te vendi i riintegrit, për të pasur mundësinë e aksesimit të shërbimeve, përfshin dokumente të ndryshme (karta identiteti për të gjithë anëtarët e familjes, një kontratë qiraje të noterizuar dhe një kërkesë për transferimin e gjendjes civile), proces pas së cilit ata mund të aplikojnë për akses në shërbime të ndryshme, duke përfshirë aksesin në shkollë/kopsht, kartë shëndeti, subvencion qiraje, regjistrim në zyrën e punës dhe akses në dokumente.

“ Sipas ligjit, duhet të merrni [pagesën për fëmijën], por është e nevojshme të përgatitni shumë certifikata, gjë që përfshin kohë dhe distancë të madhe. Dhe nëse shkoni vajtje-ardhje, shpenzoni më shumë para sesa do të fitoni... Nuk është shumë e mundur [që të regjistrohesh në kryeqytet] sepse dikush duhet të ketë vullnetin të më regjistrojë në adresën e vet. Nëse [motra ime] më regjistron në apartamentin e saj, ajo duhet të paguajë fatura dhe taksa shtesë. (Viktimë e trafikimit)²⁸

Madje edhe ata fëmijë që janë regjistruar ligjërisht mund të mos jenë në gjendje të aksesojnë shërbime dhe mbështetje, për shkak të rregullave dhe kërkesave administrative, si dhe procedurave tejet burokratike. Aksesin në të gjitha shërbimet kërkon gjithmonë përgatitjen e dokumenteve. Regjistrimi i fëmijëve në shkollë në qytetin ku nëna ka vendosur të qëndrojë kërkon transferimin e dokumenteve të regjistrimit nga njëra shkollë te tjetra nëpërmjet drejtorisë arsimore rajonale. Kur aplikohet për strehim të subvencionuar (certifikata, deklarata dhe prova të ndryshme), ose për programe të tjera, si çerdhe, kujdes ditor, kopsht, e kështu me radhë, duhet të plotësohen shumë dokumente.

²⁸ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 81.



Problemet dhe nevojat administrative

“Emi” është viktimë e trafikimit. Ajo mbeti shtatzënë gjatë trafikimit dhe e lindi vajzën e saj “Lara” jashtë vendit. Megjithatë, Lara nuk u lind në pavionin e maternitetit, por në një mjedis të ndryshëm dhe Emi nuk kishte asnjë dokument për të provuar se Lara ishte vajza e saj. Procedurat ligjore për regjistrimin e vajzës në gjendjen civile u kryen menjëherë, ashtu si edhe procesi gjyqësor për të vërtetuar amësinë e Emit. U krye një test ADN-je dhe pas të cilit u regjistrua formalisht.

“Nora” është viktimë e trafikimit që e lindi djalin nga një përvojë trafikimi. Nora aplikoi që djali i saj të kishte statusin e jetimit (të cilin ai e përfitoi pasi lindi jashtë martese dhe babai i tij nuk e njihte atësinë). Falë këtij statusi, fëmija përfitoi asistencë financiare, lehtësira për materialet dhe tekstet shkollore, etj.

“Suela” është nëna e Leas. Ajo dhe bashkëshorti i saj u divorcuan pas situatës së saj të trafikimit. Ajo po e rrit Lean e vetme dhe ish bashkëshorti nuk ofron asnjë lloj mbështetjeje. Në vendimin e gjykatës për divorcin e tyre, kujdestaria ligjore e Leas i kaloi Suelës, dhe babai i saj u detyrua të paguante mbështetje mujore për fëmijën, të cilin nuk e pagoi për shumë kohë. Suela u asistua për ta ndjekur rastin në zyrën e përmbarimit dhe u mundësua ekzekutimi i detyrimit nga ish bashkëshorti.

“Sara” ishte nënë e tre fëmijëve. Ajo dhe bashkëshorti i saj u divorcuan dhe ai fitoi kujdestarinë parësore të fëmijëve, edhe pse asaj iu dha e drejta për ta vizituar çdo javë. Pak kohë pasi u divorcua, ajo u trafikua dhe rrjedhimisht nuk i pa dhe as foli me fëmijët e saj për më shumë se një vit. Kur u kthye në Shqipëri, ajo donte të takonte fëmijët e saj, por ish bashkëshorti nuk e lejoi, pavarësisht vendimit të gjykatës për vizita javore. Ish bashkëshorti i saj bëri edhe një kërkesë në gjykatë për t’i hequr asaj të drejtat prindërore, e cila u refuzua.

Marrëdhëniet dhe çështjet ndërpersonale

Në marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve viktimë të trafikimit dhe prindit të tyre, familjes së tyre të gjerë dhe rrethit të gjerë shoqëror lindin çështje të ndryshme. Këto marrëdhënie janë shumë të rëndësishme për riintegrimin dhe mirëqenien afatgjatë të fëmijëve. Për rrjedhojë, mbështetja e riintegrimit të fëmijëve të viktimave të trafikimit kërkon të kuptuarit e dinamikave të ndryshme ndërpersonale të përfshira, pra ato që duhet të menaxhohen, si dhe ato që mund të optimizohen për të përmirësuar rezultatet e riintegrimit për këta fëmijë dhe familjet e tyre. Çështjet dhe tensionet kryesore lindin në marrëdhënien prind-fëmijë; në marrëdhëniet e familjes së gjerë; dhe në komunitet. Secila prej tyre trajtohet më poshtë.

Çështjet në marrëdhënien prind-fëmijë

Fëmijët që mbeten në shtëpi hasin shpesh vështirësi gjatë mungesës së prindërve të tyre, pasi kanë pak ose aspak kontakte, shpesh pa ndonjë shpjegim, dhe rrjedhimisht ndihen të braktisur, të refuzuar dhe të vetëm pa praninë e prindit. Shpesh këto ndjenja ndërthuren me faktorë stresi shtesë, si



mospasja e parave të mjaftueshme për nevojat bazë, mungesa e kujdesit të duhur nga personat nën kujdesin e

të cilëve lihen nga prindi i tyre, dhe/ose nga kujdestari i tyre që mund të mos jetë i përgatitur për t'u kujdesur për ta financiarisht, fizikisht ose emocionalisht.

Kur prindërit kthehen nga një përvojë trafikimi, fëmijët kanë një larmi emocionesh dhe reagimesh. Disa fëmijë mund të mos e pranojnë në fillim prindin e kthyer, për shkak të ndjenjave të braktisjes dhe indinjatës. Ata nuk e kanë parë nënën e tyre për një kohë të gjatë dhe në përgjithësi nuk kishin kontakte gjatë mungesës së saj. Disa fëmijë ishin aq të vegjël kur prindi u largua sa që nuk i mbajnë mend ose nuk ndihen të lidhur me ta.

Kur kthehen në shtëpi, në përgjithësi pas shumë vitesh larg dhe pa kontakte gjatë asaj kohe, shpesh fëmijët ngurrojnë t'iu afrohen, të paktën për pak kohë.

Disa fëmijë nuk lidhen me prindin e kthyer ose nuk e pranojnë atë në rolin e prindit, në fillim dhe për pak kohë, dhe sidomos kur sillen në mënyra “jonormale” ose emocionalisht të paqëndrueshme.



Ai nuk do të më flasë. Nuk do të flejë me mua. Nuk do të lahet me mua. Vetëm me gjyshen e tij. Sepse ai nuk më njeh. “Ik, ik” më thotë. (Grua e trafikuar kur djali i saj ishte shumë i vogël)²⁹



Mami më braktisi kur isha dy vjeç. Ajo nuk më donte, kështu që nuk mund të prisja që të tjerët të më donin. Prandaj, nuk më intereson për askënd. Askush nuk dëshiron më të mirën për mua. Nuk i besoj askujt për asgjë. (Fëmijë e një viktime trafikimi, që më vonë u trafikua për shfrytëzim seksual)



Shqetësimi më i madh që kisha ishte se djali nuk do të më donte më... por pas kthimit tim... falë prindërve të mi, asgjë nuk kishte ndryshuar. (Nënë e trafikuar me një djalë të vogël)



Nuk do të doja që vajza ime të më rikujtojë periudhën që nuk isha në shtëpi dhe se çfarë bëra. Kam frikë se do të më thotë: “Ti u largove dhe nuk ishe pranë meje gjatë fëmijërisë sime”. Nuk dua të dëgjoj fjalën “Faleminderit” nga ajo, por nuk dua as të më qortojë. Më frikëson ideja që një ditë ajo do të inatoset me mua që e lashë vetëm, dhe kjo frikë shtohet dita-ditës. (Nënë e trafikuar me një vajzë të vogël)³⁰

²⁹ Surtees, R. (2017) ‘Të qenit në shtëpi. Eksplorimi i riintegritimit në familje te punëtorët indonezianë vendas të trafikuar’, Te R. Piotrowicz, C. Rijken dhe B. Heide Uhl (Eds.) *Udhëzuesi Routledge mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore*. Routledge.

³⁰ Peled, E., & Parker, A. (2013) ‘Përvojat e amësisë së grave të trafikuar për shfrytëzim seksual: Ndërmjet këtu dhe atje’, *Revista Amerikane e Ortopsikiatrisë*, 83(4), f. 582.

Disa fëmijë ishin të ekspozuar ndaj komenteve negative dhe thashethemeve për prindin e tyre gjatë mungesës së tyre, nga ana e prindit tjetër, gjyshërve, të afërmeve ose fqinjëve. Zakonisht, fëmijët dëgjojnë akuza (në familje ose komunitet) se prindi i tyre nuk kujdeset për familjen, se i shpenzon paratë pa kriter jashtë vendit, se nuk i do fëmijët e vet, se është përfshirë në prostitucion ose kryen krime jashtë vendit, se është në burg, e kështu me radhë. Kjo njosollos perceptimin e fëmijës për prindin dhe i bën ata të acarohen dhe indinjohen, duke ndikuar në këtë mënyrë në marrëdhënien e tyre. Në disa raste, prindi i kthyer nuk lejohet nga prindi tjetër që të flasë dhe takojë fëmijët për shkak të inatit dhe indinjatës për mungesën e tij. Në raste të tjera, fëmijët janë kaq të ndikuar nga gjërat negative që kanë dëgjuar për prindin e kthyer saqë refuzojnë të kenë të bëjnë me të.

Disa fëmijë janë të zhgënjyer (dhe madje të inatosur) me prindin e tyre që nuk është kthyer me para, çka është edhe arsyeja për të cilën ata kanë emigruar dhe për ndarjen e gjatë nga fëmijët e tyre.

Kur prindërit janë të stresuar, të palumtur dhe/ose nuk ndihen mirë emocionalisht ose psikologjikisht (reagime të zakonshme të një përvoje trafikimi), ata nuk sillen gjithmonë në mënyrat më pozitive, gjë që përkeqëson më tej tensionet dhe vështirësitë në marrëdhëniet me fëmijët e tyre. Nga ana tjetër, prindërit e kthyer ndihen shpesh thellësisht të lënduar nga distanca, ngurrimi, refuzimi dhe mungesa e respektit nga ana e fëmijëve, pasi mendojnë se kanë sakrifikuar shumë për të siguruar jetesën e fëmijëve të tyre. Mund të duhet pak kohë që prindërit e kthyer të rrijnë vendin e tyre në jetën e fëmijëve.³¹

”

“Cdo nënë që e ka lënë fëmijën e ka bërë për të punuar dhe për të fituar para, jo sepse dëshiron një jetë të mirë dhe sepse dëshiron që pikë së pari t’i bëjë mirë vetes. (Nënë e trafikuar me një djalë të vogël, të cilin e la pas kur u trafikua)³¹

”

“Së shpejti bëhen pesë vjet që nuk e kam parë. Pavarësisht se sa para mund t’i dërgoj dhe se sa gjëra mund t’i ble, nuk mund t’ia rikthej atë dashuri, atë që ai ka nevojë.... E lashë dhe nuk mund t’i jap dashuri, nuk i tregoj histori në mbrëmje. Si mund të largohet dikush dhe të mos mendojë për të, për të jetuar një jetë normale?! ... Ndiem sikur shpirtin e kam në Rusi dhe trupin këtu. (Nënë e trafikuar me një djalë të vogël)³²

”

“Ajo përpiqet ta mbrojë kur mendon se nëna e saj po “sulmohet” me fjalë. Ajo kërkon të marrë vendime për nënën e saj; ajo nuk e dëgjon të ëmën, e kritikon dhe ua përshkruan gjërat. Ndërmjet këtu ndihmëherë e fajëson të ëmën për situatën. Ajo është si një i mitur me nënën e saj. (Punonjës social)

”

³¹Peled, E., & Parker, A. (2013) ‘Përvojat e amësisë së grave të trafikuar për shfrytëzim seksual: Ndërmjet këtu dhe atje’, *Revista Amerikane e Ortopsikiatrisë*, 83(4), f. 581.

³²Peled, E., & Parker, A. (2013) ‘Përvojat e amësisë së grave të trafikuar për shfrytëzim seksual: Ndërmjet këtu dhe atje’, *Revista Amerikane e Ortopsikiatrisë*, 83(4), f. 582.

³³Brunovskis, A., & Surtees, R. (2012) *Një panoramë më e plotë. Adresimi i nevojave për asistencë cenushtëmërive*. Oslo: Fafo & Uashington, DC: Instituti NEXUS.

³⁴Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 81.

Kur fëmijët janë trafikuar bashkë me prindin, në marrëdhënien e tyre lindin tensione dhe probleme të tjera. Gjatë trafikimit, fëmija mund të fajësojë dhe të jetë i inatosur me prindin për situatën në të cilën ata gjenden. Fëmija ka ëndrra dhe dëshira që nuk mund të realizohen për shkak të situatës, gjë që krijon ndjenjat e frustrimit dhe fajit te fëmija. Në raste të tjera (ose herë të tjera), fëmija mund të marrë përsipër shumë përgjegjësi për prindin dhe të përpiqet ta mbrojë atë nga trafikanti, çka është një barrë e madhe për ta mbajtur fëmija.

Marrëdhëniet nënë-fëmijë me fëmijët e lindur nga trafikimi janë komplekse dhe shpesh kontradiktore. Në disa raste, ndjenjat e amësisë komprometohen rëndë nga lindja e një fëmije nga marrëdhënie seksuale me forcë me një klient, trafikant ose “bashkëshorti”. Shumë gra duan ta ndërpresin shtatzëninë e tyre, por nuk kanë akses në strukturat e abortit ose shtatzënia ka përparuar shumë dhe nuk mund të ndërpritet.

Pas lindjes, disa gra kanë vështirësi për t'u lidhur me fëmijët e tyre, ku disa nëna i braktisin fëmijët dhe shumë të tjera e mendojnë këtë alternativë në faza të ndryshme. Nga ana tjetër, disa gra e përqafojnë amësinë pavarësisht (ose ndoshta për shkak të) rrethanave dhe janë mjaft të lidhura me fëmijët e tyre. Në disa raste, nënat zhvillojnë sjellje tejet protektive, të cilat ndikojnë negativisht në ndjenjën e pavarësisë dhe në aftësinë e fëmijës për të ndërmarrë rreziqe.

Shumë fëmijë të lindur gjatë dhe nga trafikimi janë shumë të lidhur dhe të varur nga nënat e tyre, pjesërisht sepse është marrëdhënia e tyre e vetme e sigurt dhe pjesërisht për atë që kanë parë që nënat e tyre kanë përballuar.

Fëmijët e tjerë të lindur gjatë trafikimit janë indiferentë ndaj nënave për shkak të neglizhimit, refuzimit dhe kujdesit e vëmendjes jo të vazhdueshme që kanë marrë nga to. Disa fëmijë më të rritur, që janë ekspozuar ndaj stresit të madh, dhunës dhe traumës me kalimin e kohës, shfaqin ndjenja më komplekse, kontradiktore dhe ndonjëherë armiqësore ndaj nënave të tyre (për shembull, faj dhe ndjenja indinjate, krahas mbrojtjes dhe afeksionit).

Në disa situata, familja e viktimës nuk e pranon viktimën dhe fëmijën e saj që të jetojë me ta, ose i detyron të zgjedhin nëse do të mbajnë fëmijën apo do të kthehen në shtëpi. Disa familje të

“ Shpesh, këto nëna i refuzojnë fëmijët në lindje dhe duhen përpjekje për të krijuar një marrëdhënie normale ndërmjet nënës dhe fëmijës. Mesazhi kryesor është e nuk është fëmija i burrit abuzues, është fëmija i saj, vetëm fëmija i saj. (Punonjës social)³⁵ ”

“ Zakonisht, ato mbeten shtatzënë kundër vullnetit të tyre, dhe rrjedhimisht reagojnë negativisht ndaj shtatzënisë... Disa thonë se i sjell kujtime të këqija të abuzimit seksual, të burrave të padashur që i kanë bërë të palumtura, ata nuk duan ta vazhdojnë atë shtatzëni” (Punonjës social)³⁶ ”

“ Ndonjëherë, ne shohim që nënat janë më të lidhura me fëmijët që kanë pasur pas trafikimit sesa me atë që i kanë lënë pas [në shtëpi]. (Punonjës social)³⁷ ”

³⁵ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 81.

³⁶ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 81.

³⁷ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 81.

viktimave e shtynjë viktimën që të braktisë fëmijët ose t'i sistemojë ata në një institucion. Edhe kur ato vendosin t'i mbajnë fëmijët, mendimi i braktisjes mund të rikthehet, sidomos në periudha të vështira. Në fund, disa viktima përfundojnë duke e braktisur fëmijën.

Problemet dhe tensionet në marrëdhëniet prind-fëmijë

“Tara”, nënë e tre fëmijëve, humbi kujdestarinë e tyre kur u trafikua, dhe pas trafikimit bashkëshorti i saj do të duhej të zbatonte vendimin e gjykatës për vizita javore. Ajo shkon fshehurazi te shkolla e tyre për t'i takuar. Fëmijët ishin shumë të hutuar kur e panë nënën e tyre, pasi u kishte munguar, por kishin dëgjuar gjëra të tmerrshme për të nga babai dhe gjyshja e tyre. Në fillim, vetëm vajza më e vogël pranoi ta takonte. U desh kohë e gjatë para se edhe fëmijët e tjerë që binin dakord për ta takuar dhe pranuar atë jetën e tyre.

“Tea” sapo e lindi fëmijën ua la prindërve për t'u kujdesur. Ajo u largua jashtë vendit për të punuar dhe u kthyer pas disa vitesh. Pas kthimit, ajo vendosi ta merrte vajzën dhe të jetonin bashkë, por vajza e saj 6-vjeçare kishte refuzuar tashmë të shkonte dhe të jetonte me nënën e vet. Ajo nuk kishte qenë aty prej vitesh dhe vajza nuk e ndiente dhe nuk dëshironte që të ndahej nga gjyshja që e kishte rritur. Pasi e mori vajzën dhe filloi të jetonte me të, marrëdhënia e tyre u përkeqësua. Fëmija e saj u bë shumë agresiv, refuzonte të hante dhe të shkonte në shkollë. Ajo donte vetëm të kthehej dhe të jetonte me gjyshen.

Problemet në marrëdhëniet familjare

Marrëdhëniet familjare janë shumë të rëndësishme lidhur me mënyrën se si viktimat dhe fëmijët e tyre janë në gjendje të riintegrohen pas trafikimit.



Megjithatë, kthimi në shtëpi pa para dhe shpesh pas mungesave të gjata pa kontakt, është një burim i tensionit të konsiderueshëm ndërmjet prindit të trafikuar dhe familjes së lënë pas, pra burrit, gruas ose të afërmeve të tjerë, shpesh edhe përgjegjës për kujdesin për fëmijët e mbetur në shtëpi. Borxhet për emigrimin dhe borxhet e shkaktuara nga kujdesi për fëmijët në shtëpi vetëm sa i përkeqëson këto probleme dhe indinjatat.

“ Ishte një periudhë kur marrëdhënia me fëmijët e mi ishte e prishur. ... Ata dëgjonin vetëm njërën anë të historisë nga familja e tyre ose komuniteti përreth tyre... se unë jam ai lloj personi që nuk merr përgjegjësi, ose se jam një person i keq. (Viktimë e trafikimit)³⁸ ”

“ Vazhdova të punoja dhe u përpoqa të siguroja të ardhura për familjen, por gruaja mendonte se nuk mjaftonte. Shpesh grindeshim. Ajo mendonte se gjatë tre viteve larg nuk e kishte përditësuar dhe nuk i kishte dhënë para, madje ”

³⁸ Surtees, R. (2018) ‘Në shtëpi. Riintegrimi në familje i meshkujve indonezianë të trafikuar’, *Vlerësimi kundër trafikimit*. Nr. 10

Shpesh, pjesëtarët e familjes janë thellësisht të lënduar dhe shqetësuar nga mungesa dhe heshtja e viktimës, dhe vuajnë shumë gjatë kësaj kohe, si financiarisht ashtu edhe emocionalisht. Frustrimi dhe lëndimi mund t'i bëjë ata të mendojnë më të keqen dhe të akuzojnë prindin e trafikuar si neglizhues, të papërgjegjshëm, që shpenzon por nuk dërgon para në shtëpi, që nuk e do familjen e tij dhe që bën gjëra të këqija ndërkohë që është larg, akuza që ndikojnë në mënyrën se si fëmijët në shtëpi e shohin dhe perceptojnë prindin e tyre. Mungesa e komunikimit teksa janë larg është një burim i stresit dhe indinjatës së madhe, dhe ndërthuret me keqperceptimet dhe keqkuptimet.

Tensionet lindin edhe në familjen e gjerë nga “dështimi” në emigrimin e tyre, pra për burrin si bashkëshort, baba dhe/ose djalë, dhe për gruan si nënë, bashkëshorte dhe/ose vajzë. Ndonjëherë, pritshmëritë e papërbushura sjellin zhgënjim, faj dhe akuza. Disa fëmijë janë të zhgënjyer nga “dështimi” i prindit të tyre dhe prindi, nga ana tjetër, është i stresuar që nuk është në gjendje të mbështesë fëmijët e vet. Fëmijët që jetojnë në një mjedis të gjerë familjar janë ndikuar dhe prekur nga emocionet dhe reagimet e pjesëtarëve të familjes me të cilët jetojnë.

Kur viktimat kthehen në shtëpi, ata janë shpesh të stresuar dhe të traumatizuar, dhe mund të jetë shumë e vështirë edhe për familjen më mbështetëse që ta kuptojë këtë.

Përvoja e traumës mund të pengojë aftësinë e prindërve për t'u sjellë dhe ndërvepruar me fëmijët e tyre në mënyra të shëndetshme.

Nga ana tjetër, kjo mund të sjellë frustrimin e familjes dhe tendencën për të fajësuar viktimën për veprimet dhe reagimet e tyre.

familja ime mendonte se kisha vdekur, duke qenë se nuk kishin dëgjuar kurrë për mua për dy vjet e gjysmë. [Marrëdhënia jonë kur erdha në shtëpi] ishte shumë e mirë. Një herë gruaja tha se ishte në rregull që të qëndronim në fshat, mund t'ia dilnim me çdo lloj pune që mund të gjenim. Të bënim jetë normale. Por në fund gjërat ndryshuan. [...] Në shtatë muaj. Qëndrimi i saj filloi të ndryshonte dhe ngriti problemin kur unë isha larg duke lundruar shumë. [...] Se punova për tre vjet, por nuk dërgova kurrë para në shtëpi për të mbuluar shpenzimet e përditshme dhe të shkollimit të fëmijëve tanë, etj. Gjithmonë e përmendte këtë. (Burrë, viktimë e trafikimit)³⁹

”

“ Kur u ktheva në shtëpi, u shqetësova shumë, sidomos për të gjitha borxhet... U ktheva në shtëpi si dështak dy herë, dhe herën e dytë solla shumë barrë. ... Shqetësohem shumë për familjen, fëmijët dhe shtëpinë time. (Burrë, viktimë e trafikimit)

”

“ [Isha] i paqëndrueshëm dhe i tronditur. Mendova shumë për kostot dhe ngjarjet fatkeqe kur isha atje. Kurrë më parë nuk kam përjetuar diçka të tillë. Në fakt, nuk dija se çfarë të mendoja. Nuk dija se ku të kërkoja ndihmë. ... Fëmijët ishin të tronditur. Inatosesha lehtë. (Burrë, viktimë e trafikimit dhe baba)⁴⁰

”

³⁹ Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS, f. 72.

⁴⁰ Surtees, R. (2018) 'Në shtëpi. Riintegrimi në familje i meshkujve indonezianë të trafikuar', *Vlerësimi kundër trafikimit*, Nr. 10.

Në shumë raste, fëmijët e grave të trafikuar e përjetojnë mungesën e nënës së tyre si braktisje dhe neglizhim. Ky reagim është më pak i theksuar te baballarët e trafikuar, të cilët kanë më pak gjasa të fajësohen dhe refuzohen, apo të vuajnë dëme të pariparueshme në marrëdhënien me fëmijët e tyre. Kjo ka gjasa sepse mungesa nga emigrimi e burrave shihet shpesh në kuadër të rolit të tyre si personi që nxjerr bukën e familjes dhe sepse fëmijët jetojnë zakonisht me nënën në mungesë të të atit. Nga ana tjetër, roli i grave si emigrante dhe si personi që nxjerr bukën e gojës, edhe pse është normale dhe e zakonshme, bie ndesh me rolin e nënës dhe personit që i ushqen. Dhe kur nënat emigrojnë, baballarët që qëndrojnë në shtëpi nuk kujdesen gjithmonë për fëmijët e tyre në mungesë të nënave, duke rritur ndikimin e mungesës së saj.⁴²

“ Shpesh, situata do të ishte kjo: Ajo nuk telefonon në shtëpi, të afërmit po e kërkonin ose jo, dhe në të njëjtën kohë fëmijës i tregohen histori: “Mami të la”, “ajo është prostitutë ose njeri i keq”, “i gjithë fshati e di se çfarë bën ajo”. Pra, ajo kthehet, mjaft agresive, mjaft e paqëndrueshme emocionalisht dhe ju, si fëmijë, shihni që ajo grindet me babin dhe gjithë kohës ti mendon: “Ajo më la.” Ajo të bërtet ose sillet çuditshëm, dhe kjo është arsyeja se përse fëmijët fillojnë të mos i pranojnë nënat. Kjo do të thotë se ata nuk kanë dëshirë të flasin, t’i dëgjojnë, t’i kenë ato si autoritet prindëror, ata e shpërfillin. Gruaja e kupton dhe bëhet më shumë shtytëse, agresive, jomirëkuptuese. “Fëmija është i keq, ai është rritur keq, ai nuk më dëgjon, ai nuk më mbështet dhe unë po bëj më të mirën time për t’u përshtatur këtu”. (Punonjës social)⁴¹

“ Kur një grua kthehet, ajo ka një përvojë traumatike, sjellja, emocionet dhe marrëdhëniet e saj ndryshojnë, dhe shumë shpesh ata (familja) nuk e kuptojnë. Dhe ajo nuk do të tregojë se çfarë ndodhi. Ajo qan gjithë kohës dhe nuk mund të frenojë veten nga shfaqja e sjelljeve agresive. Ose ajo pi duhan gjithë kohës, pi kafe dhe alkool, qëndron në bare gjithë kohës, ndërton burrat. Këto janë reagime ose simptoma të çrregullimit të stresit të rëndë post-traumatik. Dhe të afërmit e saj nuk e kuptojnë dhe përpiqen të zbulojnë se përse ajo është kështu. (Punonjës social)⁴³

⁴¹Brunovskis, A., & Surtees, R. (2012) *Askund si shtëpia? Sfidat e riintegritimit në familje pas trafikimit*. Osl: Fafod dhe Uashington, DC: Instituti NEXUS, f. 3.1

⁴² Surtees, R. (2018) ‘Në shtëpi. Riintegritimi në familje i meshkujve indonezianë të trafikuar’, *Vlerësimi kundër trafikimit*, Nr. 10; Surtees, R. (2017) ‘Të qenit në shtëpi. Eksplorimi i riintegritimit në familje te punëtorët indonezianë vendas të trafikuar’, Te R. Piotrowicz, C. Rijken dhe B. Heide Uhl (Eds.) *Udhëzuesi Routledge mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore*. Routledge.

⁴³Brunovskis, A., & Surtees, R. (2012) *Askund si shtëpia? Sfidat e riintegritimit në familje pas trafikimit*. Osl: Fafod dhe Uashington, DC: Instituti NEXUS, f. 29.

Kthimi në shtëpi shtatzënë ose me një fëmijë të lindur nga një përvojë trafikimi është burim i tensionit dhe stresit të madh, zakonisht për shkak të shqetësimeve për turpin dhe stigmën lidhur me përfshirjen e saj faktike apo të supozuar në prostitucion. Shumë fëmijë të lindur nga trafikimi përballen me armiqësi nga bashkëshorti i nënës së tyre dhe disa bashkëshortë këmbëngulin te fakti që nënat e braktisin fëmijën e lindur gjatë trafikimit për të mbrojtur martesën. Disa bashkëshortë jo vetëm që refuzojnë kthimin e viktimës të trafikimit dhe të fëmijës së saj, por edhe e detyrojnë atë të heqë dorë nga të drejtat për fëmijët e saj të mbetur pas, dhe pengojnë marrëdhënien e mëtejshme me këta fëmijë.



Disa gra ishin shtatzëna kur emigruan dhe fëmija me të cilin ato janë kthyer në shtëpi është fëmija i bashkëshortit të saj në shtëpi. Megjithatë, nuk është e pazakontë që bashkëshorti të mos e besojë se është kështu dhe e refuzon bashkëshorten dhe fëmijën.

Disa gra që i lanë fëmijët pas u kthyen në shtëpi me një fëmijë të lindur nga situata e tyre e trafikimit. Marrëdhëniet ndërmjet motrave/vëllezërve ndikohen shumë nga reagimet dhe sjelljet e familjes në shtëpi, sidomos nga babai. Marrëdhëniet ndërmjet motrave/vëllezërve janë shpesh më pak të komplikuar kur baballarët dhe vjehri/vjehrra nuk janë të pranishëm. Në të vërtetë, disa motra/vëllezër janë të dobishëm, madje qendrorë, në vendimet e nënave për t'i mbajtur fëmijët e lindur nga trafikimi.

Në raste të tjera, janë prindërit e gruas (ose të afërm të tjerë) që nuk e pranojnë fëmijën për shkak të shqetësimeve për turpin dhe stigmën në komunitetin e gjerë, dhe presioni i një tjetër goje për t'u ushqyer. Në disa raste, gratë nuk kthehen në shtëpi sepse nuk ndihen në gjendje t'iu tregojnë prindërve të tyre për foshnjën.

Megjithatë, ky refuzim nuk është i pashmangshëm dhe disa gra gjejnë mbështetje dhe pranim brenda familjes së tyre, dhe për fëmijët e tyre. Disa viktimat të trafikimit të kthyer gjejnë mbështetje te nënat, baballarët, motrat/vëllezërit dhe të afërm të tjerë në pranimin dhe mbështetjen e tyre pas trafikimit, si dhe të fëmijëve të tyre të lindur nga trafikimi. Në disa raste, kjo nuk ndodh menjëherë pas trafikimit. Disa familje bëhen mbështetëse pas një periudhe kohe. Një numër i vogël bashkëshortësh i pranojnë gratë e tyre, me fëmijët e lindur nga trafikimi. Ndërmjetësimi dhe këshillimi i familjes mund të luajë një rol të rëndësishëm dhe efektiv në menaxhimin dhe përmirësimin e këtyre marrëdhënieve. Në disa raste, është e mundur që të komunikohet dhe ndërmjetësohet direkt me pjesëtarët e familjes së viktimës. Megjithatë, në raste të tjera, është e nevojshme që të gjendet dikush tjetër në familje që shfaq simpati për situatën dhe

“ Kur ne telefonuam nënën, ajo qante në telefon dhe pyeti: “Kur do të vish për ta marrë këtë fëmijë?” Dhe 8-vjeçarja e dëgjoi këtë. Mund ta imagjinoni se sa stresuese ishte kjo për fëmijën dhe se sa e pjekur është ajo për të thënë: “Kjo është motra jonë dhe ajo duhet të qëndrojë me ne.” (Punonjës social)⁴⁴

“ [Ajo] është bërë fëmija jonë, një pjesë e familjes sonë. [Ajo] mbushi pesë vjeç dhe unë i solla një tortë dhe disa qirinj, dhe motra ime erdhi me fëmijën e saj dhe motrën tjetër. Vajzës sime i pëlqen kur ne këndojmë këngën e ditëlindjes, kështu që ia kënduam. Më pas, ne e hipëm në karrige, e ngritëm bashkë me karrigen pesë herë. (Grua që u kthye në shtëpi me një fëmijë nga trafikimi)⁴⁵

“ Mezi prisnim ta shihnim kur u kthye. Ishim shumë të shqetësuar. Ne ishim shumë të emocionuar që ajo u kthye saqë e pranuar foshnjën (Nënë e një viktimë trafikimi nën moshë që u kthye në shtëpi shtatzënë)⁴⁶

⁴⁴ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 88.

⁴⁵ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 90.

⁴⁶ Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Ta lëmë pas të shkuarën. Kur viktimat e trafikimit refuzojnë asistencën*. Oslo: Fafo & Uashington, DC: Instituti NEXUS.

që mund t'i ndihmojë pjesëtarët e tjerë të familjes të kuptojnë se çfarë ka ndodhur dhe për ta parë nga një këndvështrim tjetër.

Tensionet dhe problemet në mjedisin familjar

“Albana” i la dy fëmijët me prindërit e saj kur ajo emigroi dhe u kthye me dy fëmijë të lindur gjatë trafikimit. Fëmija i parë ishte i bashkëshortit të saj, dhe i dyti ishte i trafikantit. Për pak kohë, ajo ishte gati ta braktiste fëmijën më të vogël, një kujtesë e vazhdueshme e asaj që ajo kishte përjetuar. Në të njëjtën kohë, gruaja u refuzua nga bashkëshorti (i cili mohoi atësinë e fëmijës së parë të lindur gjatë trafikimit) dhe ishte në konflikt me prindërit e saj se nuk fitonte para dhe për kthimin në shtëpi me fëmijët që nëna/gjyshja i përshkruanin si “barrë për familjen tonë”. Edhe fëmijët më të mëdhenj, përkatësisht 6 dhe 8 vjeç kur nëna e kthye, po vuanin, sidomos për faktin se Albana ishte në stres dhe depresion. Ata kanë dëgjuar edhe thashetheme për të teksa ajo jetonte larg dhe sepse u kthye me dy fëmijë. Pavarësisht këtyre tensioneve, fëmijët i donin motrat/vëllezërit e tyre më të vegjël dhe ndërhyjnë kur dëgjuan Albanën të fliste për braktisjen e fëmijës më të vogël.

“Liliana” lindi një fëmijë gjatë trafikimit jashtë vendit dhe po mendonte ta braktiste atë para se të kthehej në shtëpi. Ajo telefonoi motrën për këshilla: “... motra më tha vetëm: ‘merre fëmijën dhe kthehu në shtëpi.’” Me kthimin në shtëpi motra ishte mbështetëse, ashtu si edhe fëmijët që ajo kishte lënë në shtëpi kur emigroi. Ato e ndihmuan që ta donte fëmijën e vogël.⁴⁷

“Altin” u trafikua jashtë vendit për shfrytëzim seksual dhe lindi dy fëmijë gjatë trafikimit. Pavarësisht kthimit në shtëpi e pamartuar dhe me dy fëmijë, Altin përshkroi një pritje të ngrohtë nga nëna e saj: “Nëna më priti mirë... ajo më kuptoi, dhe më qetësoi”.⁴⁸

“Adriel” u trafikua për shfrytëzim seksual. Ajo lindi dy fëmijë jashtë vendit me të cilët u kthye në shtëpi pasi u arratis nga situata e saj e trafikimit. Ajo u prit ngrohtë nga nëna e saj që e përqafoi dhe mirëpriti dy fëmijët e saj të vegjël. Që prej kthimit të saj, nëna e saj ishte shumë e shqetësuar për mirëqenien e saj dhe mbështetëse në të gjitha mënyrat: “Kudo që shkoj ajo shqetësohet për mua... Ka frikë se do të humb”.⁴⁹

“Elira” u trafikua për punë. Kur u largua, martesë dhe familja e saj ishin të lumtur. Por, mungesa e kontaktit gjatë trafikimit, plus mungesa e remitancave, nënkuptonte se ajo ishte në prag të prishjes: [Pas kthimit], vazhdova të punoja dhe u përpoqa të siguroja të ardhura për familjen, por gruaja mendonte se nuk mjaftonte. Shpesh grindeshim. Ajo mendonte se gjatë tre viteve larg nuk e kishte përditësuar dhe nuk i kishte dhënë para. Madje, familja mendonte se kisha vdekur pasi nuk kishin dëgjuar kurrë për mua për dy vjet e gjysmë.⁵⁰

⁴⁷ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 90.

⁴⁸ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 89.

⁴⁹ Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse të viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS, f. 60.

⁵⁰ Surtees, R. (2018) ‘Në shtëpi. Riintegrimi në familje të meshkujve indonezianë të trafikuar’, *Vlerësimi kundër trafikimit*, Nr. 10;



“Grace” është nënë e divorcuar e dy fëmijëve, e cila i la fëmijët nën kujdesin e nënës së saj të moshuar kur ajo emigroi për punë, por që përfundoi e trafikuar. Nëna e saj kishte vështirësi për të mbështetur fëmijën e saj të vogël kur ajo punonte jashtë vendit dhe ish bashkëshorti i saj nuk ofroi aspak ndihmë. Kjo nënkuptonte futjen në borxh të motra e ish bashkëshortit për të mbuluar nevojat bazë të fëmijëve: “[Kunata] tha: ‘Ke borxh [273 dollarë amerikanë]. Ishte për fëmijët e tu kur ata u vizituan të mjeku dhe për të blerë qumësht’... Por, kuptova se ish bashkëshorti nuk më dha kurrë asgjë...”⁵¹

Kur “Katrina” erdhi për herë të parë në strehëz me fëmijën e saj, ajo nuk kishte fare marrëdhënie me pjesëtarët e familjes së saj. Ata nuk donin ta takonin, të flisnin në telefon ose të mësonin për jetën e saj. Megjithatë, me kalimin e kohës, punonjësi social filloi të fliste me një nga të afërmit e saj në kryeqytet, dhe i tregoi të vërtetën se çfarë i kishte ndodhur Katrinës. Familja e saj në shtëpi ishte e inatosur pasi ajo ishte kthyer në shtëpi me një fëmijë, dhe se nuk kishin dëshirë të dëgjonin se çfarë kishte ndodhur. Megjithatë, ky i afërm e kuptoi dhe shfaqti simpati ndaj asaj që kishte vuajtur Katrina, dhe filloi të bënte ndërmjetësimin me familjen e Katrinës, duke i pyetur se përse nuk e kishin falur ende. Këto përpjekje kanë ndihmuar në rivendosjen e komunikimit ndërmjet Katrinës dhe familjes së saj, kryesisht nëpërmjet telefonit. Ndërkohë, i afërti i Katrinës është aktiv dhe i pranishëm në jetën e saj, duke e mbështetur dhe nxitur atë për të vazhduar dhe filluar një jetë të re së bashku me fëmijën e saj.⁵²

Problemet në marrëdhëniet komunitare

⁵¹Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse të viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS.

⁵²D&E (2009) *Raporti Vjetor i Të Ndryshëm & Të Barabartë*. Tiranë, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Mënyra se si pjesëtarët e komunitetit përgjigjen ndaj viktimës së kthyer të trafikimit dhe fëmijëve të tyre (qoftë të mbetur pas apo të lindur nga trafikimi) është një faktor i rëndësishëm në riintegrim.

Në fund, shumica e viktimave kthehen bashkë me fëmijët e tyre aty ku u rritën apo jetuan përpara trafikimit, dhe aty ku prindërit apo familja e saj jetojnë. Dhe shumë pjesëtarë të familjes janë shpesh thellësisht të shqetësuar për reagimet e komunitetit ndaj prindit të trafikuar.

Shumë fëmijë të mbetur pas janë të ekspozuar ndaj thashethemeve dhe komenteve negative të komunitetit për prindin e tyre trafikuar. Kjo përfshin kritika për lënien pas të fëmijëve dhe mosdërgimin e parave, si dhe thashetheme për atë që prindi bën jashtë (aktivitet kriminal ose prostitucion).

“ Qëndrimi i komunitetit mund të sjellë disa pasoja negative, sepse të gjithë pëshpëritin dhe thonë: “Çfarë ka bërë? Pse do të vazhdoni të jetoni me të?” e kështu me radhë, dhe kjo mund të çojë në divorc. Nuk di asnjë rast që viktima të jetë kthyer me një fëmijë dhe fëmija të jetë pranuar nga bashkëshorti’. (Punonjës social)⁵³

”

“ Jo, ata nuk e dinin [për trafikimin tim], por kishte thashetheme se punoja si prostitutë, duke qenë se u ktheva pas me një fëmijë. (Grua që u kthye në shtëpi me një fëmijë nga trafikimi)⁵⁴

”

“ Në përgjithësi, gratë nuk donin të kishin fëmijë nga trafikimi, duke qenë se është shenjë e keqe në një fshat ku një grua e pamartuar të ketë fëmijë. Është turp dhe kjo do të thotë se ajo nuk do të martohet kurrë, dhe fëmija i saj do të mbetet pa baba. Kjo është stigma. (Punonjës social)⁵⁵

”

⁵³Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 86.

⁵⁴ Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 90.

⁵⁵Surtees, R. (2017) ‘Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 91.

Disa fëmijë të lënë në shtëpi janë bullizuar nga shokët e tyre dhe janë ngacmuar për gjëra të pakëndshme që ata kanë dëgjuar nga prindërit e tyre për prindin e trafikuar. Kjo është stresuese për fëmijët dhe ata shpesh nuk mund të mbështeten te pjesëtarët e familjes së tyre për t'u çliruar nga këto shqetësime. Kjo mund të sjellë tension dhe reagime negative ndaj prindit të tyre kur kthehen.

Viktimat që kthehen me fëmijë ose shtatzëna përballen me thashetheme, stigmë, censurë dhe diskriminim nga pjesëtarët komunitetit. Normat shoqërore kërkojnë që gratë të kenë fëmijë vetëm brenda martesës, dhe e kundërta sjell censurë. Shumë gra nuk kthehen të jetojnë në komunitetet e tyre për shkak të stigmës kundër fëmijëve të lindur jashtë martese.

Disa as nuk i vizitojnë familjet e tyre për shkak të thashethemeve dhe problemeve që do të shkaktonte vizita e tyre në ato komunitete për amësinë e vetme. Në raste të tjera, diskriminimi lidhet me përfshirjen në prostitucion (ose përfshirjen e perceptuar në prostitucion, pasi shumë viktima e mbajnë sekret shfrytëzimin seksual).

Disa gra janë të ekspozuara ndaj ngacmimit dhe dhunës në komunitetin e tyre për shkak të përfshirjes në prostitucion (faktike apo të supozuar, dhe pavarësisht nëse kjo përfshirje ka qenë e detyruar gjatë trafikimit).⁵⁸

Reagimet e komunitetit ndikojnë edhe te fëmijët e lindur gjatë ose pas trafikimit. Shpesh, ata kanë dëgjuar thashetheme për nënat e tyre dhe rrethanat e lindjes së tyre në komunitetin e gjerë. Vetë fëmijët fajësohen dhe izoloohen për atë që perceptohet se ka bërë nëna e tyre. Po ashtu, problematike janë reagimet e fëmijëve të tjerë të fshatit, të cilët i stigmatizojnë këta fëmijë si fëmijë të viktimave të trafikimit ose të nënave të pamartuara. Kjo mund të ketë pasoja në jetën reale për fëmijët që mund të përballen me pengesa në jetën e tyre të

“ Nuk ma thonë përballë, por kam dëgjuar se janë përhapur thashetheme të pakëndshme për mua në fshat [për kthimin në shtëpi me një fëmijë]. (Grua që u kthye në shtëpi me një fëmijë nga trafikimi)⁵⁶ ”

“ Pas kësaj përvoje [trafikimi dhe pasjes së një fëmije], nuk mund të kthehem në fshat sepse njerëzit do të më tregojnë me gisht... Po, mjafton të bësh një hap dhe të gjithë do ta marrin vesh. (Grua që u kthye në shtëpi me një fëmijë nga trafikimi)⁵⁷ ”

“ Këta prindër dhe sjelljet e tyre janë ndikuar dhe ndikohen nga i gjithë komuniteti. Kjo lidhet me mendësinë. Kam ndjerë se kjo është stigmë, përveçse prek jetën e viktimave, shumë shpesh ndikon në jetën e fëmijëve të viktimave të trafikimit. (Punonjës social)⁵⁹ ”

⁵⁶ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 91.

⁵⁷ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 91.

⁵⁸ Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) 'Kthimi në shtëpi. Sfidat në riintegrimin në familje', *Qualitative Social Work*; Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *Askund si shtëpia? Sfidat e riintegritimit në familje*. Oslo: Fafo & Uashington, DC: Instituti NEXUS; Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Ta lëmë pas të shkuarën. Kur viktimat e trafikimit refuzojnë asistencën*. Oslo: Fafo & Uashington, DC: Instituti NEXUS.

⁵⁹ Surtees, R. (2017) 'Çfarë është shtëpia? (Ri)integrimi i fëmijëve të lindur nga trafikim', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2), f. 89.

përditshme, duke përfshirë bullizimin nga bashkëmoshatarët dhe përjashtimin nga aktivitetet e rregullta të fëmijëve. Disa viktime janë përballur edhe me probleme në aksesimin e shërbimeve dhe mbështetjes bazë për fëmijët e tyre, për shkak të stigmës. Për shembull, aksesimi në kujdesin për fëmijë, regjistrimi në shkollë. Në disa raste, madje edhe kur marrin shërbime, ata ende përballen me paragjykimet dhe stigmë.

Një pasojë shtesë është se pjesëtarët e komunitetit mund ta perceptojnë fëmijën si “të huaj”, kur ata duken ndryshe ose nuk flasin gjuhën e tyre amtare, ose nuk flasin fare. Ka gjasa që të jetë i vështirë integrimi në komunitetet e lidhura ngushtë.

Fëmijët që nuk sillen “si duhet” ose “normalisht” në komunitet mund të kenë probleme me integrimin. Kjo ndodh për faktin që sjelljet e tyre të mësuara vijnë nga kriminelë të dhunshëm, dhe situatat e shfrytëzimit ekstrem ndikojnë në veprimet dhe reagimet e tyre. Shumë fëmijë nuk kanë aftësi sociale dhe ndërpersonale për të menaxhuar marrëdhëniet.

Është e rëndësishme që këta fëmijë të angazhohen në aktivitete sociale dhe sportive, ta shpëtojnë dhe kanalizojnë energjinë e tyre negative. Ata përfitojnë edhe nga lloje të ndryshme të mbështetjes psikologjike, duke përfshirë terapinë dhe këshillimin nëpërmjet artit. Prindërit e trafikuar luajnë një rol të rëndësishëm në përshkrimin e këtij terreni social kompleks dhe në mbrojtjen e fëmijëve nga stigma dhe lëndimi që shfaqen në komunitet.

“ Hap pas hapi, njerëzit mësohen me situatën dhe, pas pak kohe, të afërmit dhe fqinjët mësohen me fëmijën. Fëmija i lindur nga situata e shfrytëzimit është një kujtesë që gruaja nuk mund ta harrojë, dhe është e rëndësishme se si ajo e percepton fëmijën, për të pasur strategji progresive dhe jo regresive për fëmijën, për të qenë në gjendje për të krijuar një marrëdhënie të shëndetshme me fëmijën dhe për ta mbrojtur atë në komunitet.

”

Tensionet në komunitet mund të pakësohen me kalimin e kohës, pasi prindi i trafikuar (dhe fëmijët) përshtaten më mirë me normat shoqërore, si për shembull kur nëna e vetme martohe.

Disa viktime të trafikimit e kanë mundësinë t'i besojnë një komuniteti mbështetës, pikërisht sepse nuk i zbulojnë problemet dhe shfrytëzimin që ata kanë përjetuar gjatë

“ Tani që ka një burrë mund të shkojë në komunitet me të. Problemi ishte të shkoje në komunitet me fëmijët pa pasur një burrë... Kjo është mendësia, nëse ke fëmijë duhet të kesh një burrë, të paktën në fshatin e saj. (Punonjës social)

”

trafikimit. Shpesh, kjo bëhet në mënyrë strategjike për të shmangur diskriminimin ose reagimet brenda komuniteteve të tyre.

Një tjetër strategji është që gratë dhe fëmijët e tyre të sistemohen në komunitetet e reja ku fqinjët nuk dinë asgjë për përvojën e tyre.

Një formë e rëndësishme e mbështetjes për riintegrim është ndihma për viktimat e trafikimit dhe fëmijët e tyre për të parashikuar dhe menaxhuar tensionet dhe reagimet në komunitet.



Mua dhe familjen time na trajtuan mirë. Pasi u martova, u zhvendosa në një lagje të re ku fqinjët e mi nuk e dinin situatën time.⁶⁰



Tensionet në marrëdhëniet komunitare

“Rita” u trafikua për shfrytëzim seksual. Ajo u kthye në shtëpi për të jetuar në fshatin e saj dhe u përpoq ta regjistronte fëmijën në kopsht, por u refuzua kur stafi zbuloi se ajo ishte kthyer nga jashtë vendit me një fëmijë. Prindërit e tjerë e shpërfillën sepse supozonin se ajo ishte përfshirë në prostitucion.

“Larina” u trafikua për punë shtëpie dhe u kthye në shtëpi shtatzënë pasi ishte përdhunuar gjatë trafikimit. Megjithëse burri dhe nëna e saj ishin mbështetëse, ajo u përball me probleme dhe censurë në komunitetin e saj, duke përfshirë mësuesin e fesë, i cili e deklaroi tradhtinë e saj bashkëshortore të supozuar përpara komunitetit. Ajo dhe familja e saj u përballën me shumë thashetheme dhe fyerje nga fqinjët dhe ishte mjaft e inatosur me trajtimin e nënës së vet që shqetësohej nga fqinjët: “Ata i thoshin nënës: ‘E paske [lëkurën shollë], të kesh një fëmijë si ky, e megjithatë guxon të shesësh gjëra për qark’. Shumë vetë ia kanë thënë nënës sime. [...] Dikush i tha: ‘Po të isha ti, do e kisha varur veten’”⁶¹

Udhëzime për profesionistët

Fëmijët e viktimave të trafikimit përballen jo vetëm me ndikimet e trafikimit por edhe me sfida dhe pengesa serioze kur ribashkohen me një prind të trafikuar ose kur riintegrohen te familjet dhe komunitetet e tyre. Megjithatë, zakonisht këta fëmijë nuk shihen si viktimat apo përfitues në të drejtën e tyre, në nevojën dhe gëzimin e asistencës së specializuar dhe të përshtatur. Ky është rasti

⁶⁰ Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS, f. 64.

⁶¹ Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS, f. 66.

kur vetë fëmijët kanë vuajtur së bashku me nënat e tyre në situata trafikimi, ose janë lindur në një situatë trafikimi. Kjo përbën një hendek kritik në kuadrin e riintegrit për viktimat e trafikimit.

Është e rëndësishme të kuptohen mirë dhe vlerësohen çnueshmëritë e thella dhe të ndryshme me të cilat fëmijët e viktimave të trafikimit përballen, dhe shpesh vazhdojnë të përballen me kalimin e kohës, për të qenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë ndërhyrje që plotësojnë nevojat e tyre. Më poshtë jepen udhëzime për profesionistët se si të mbështetin më mirë rikuperimin dhe riintegrimin e fëmijëve të viktimave të trafikimit, pra të atyre që kanë mbetur pas, atyre që janë trafikuar bashkë me prindin e tyre dhe atyre që janë lindur gjatë ose pas një situatë trafikimi.



Çështjet kryesore që duhen mbajtur në vëmendje në programimin e riintegrit

Udhëzime për profesionistët

✓ **Kuptoni më mire përvojat dhe nevojat e fëmijëve të viktimave të trafikimit.** Ndërtimi i njohurive dhe kuptimit të fëmijëve të viktimave të trafikimit si një kategori e veçantë përfituesish. Kjo kërkon ndergjegjësimin për përvojat dhe nevojat e tyre specifike, si dhe strategji për ti mbështetur ato në mënyre efektive. Kushtojini vëmendje gjithashtu sesi të tre kategoritë e fëmijëve (fëmijë të mbetur pas kur një prind trafikohet, fëmijë të trafikuar me prindërit e tyre ose të lindur gjatë trafikimit dhe fëmijë të lindur pas trafikimit) mund të jenë të ngjashme ose totalisht të ndryshme në problemet me të cilat përballen dhe nevojat që ata kanë. Ndërtimi i njohurive mund të behet përmes një aktiviteti kerkimor diskret, si pjesë e supervizimit dhe reflektimit të vazhdueshëm ose gjatë punës monitoruese dhe vlerësuese.

✓ **Ofroni një paketë shërbimesh gjithëpërfshirëse dhe miqësore me fëmijën për fëmijët e viktimave të trafikimit.** Sigurohuni që fëmijët e viktimave të trafikimit të marrin një paketë gjithëpërfshirëse të shërbimeve të riintegrit, bazuar në nevojat e tyre individuale dhe rrethanat e jetës që përfshin, të paktën, ato shërbime të disponueshme për prindërit e tyre të trafikuar. Gjithashtu, identifikoni dhe ofroni shërbime që plotësojnë nevojat e veçanta të fëmijëve, prindërit e të cilëve janë trafikuar. Megjithëse shërbimet e nevojshme do të variojnë në varësi të faktit nëse një fëmijë ka mbetur pas, është trafikuar me prindin e tij ose është lindur nga një përvojë trafikimi, disa shërbime zakonisht të kërkuara përfshijnë:

- aksesin në kujdesin për fëmijët (për shembull, kujdesi ditor, çerdhja, kopshti)
- shërbime dhe këshillim psikologjik (për shembull, programe të zhvillimit konjitiv, këshillim familjar)
- mbështetje shkollore (për shembull, materiale shkollore, mbështetje me detyrat e shtëpisë, klasa shtesë dhe mbështetje plotësuese)
- mbështetje ligjore (për shembull, regjistrimi në lindje, nxjerrja e dokumentave)

✓ **Asistoni prindërit e trafikuar me shërbime që forcojnë aftësinë e tyre për t'u kujdesur për fëmijët.** Identifikoni dhe ofroni shërbime që plotësojnë nevojat e veçanta të prindërve që janë trafikuar, sidomos lidhur me mënyrën se si ata mund të kujdesen për fëmijët e tyre dhe të rivendosin marrëdhëniet me fëmijët dhe familjen e gjerë. Përshtatini shërbimet me situatën dhe nevojat specifike të prindërve të trafikuar me fëmijë. Për shembull:

- ofroni kujdes pas shkolle dhe gjatë natës për fëmijët e prindërve të trafikuar që punojnë me turne ose gjatë fundjavës;
- ofroni mbështetje të dedikuar dhe personalizuar për prindin dhe fëmijën, për t'i ndihmuar në krijimin ose rivendosjen e marrëdhënieve prind-fëmijë, duke përfshirë prindërimin pozitiv;

- siguroni mbështetje prindërore për të mundësuar që sjelljet e mësuara të barten dhe përdoren në shtëpi, për të lehtësuar stresin tek prindërit dhe për t'u dhënë mundësinë atyre që ta zhvillojnë atë aftësi kujdesi në të ardhmen.

✓ **Ofroni shërbime afatgjata dhe menaxhim rasti.** Ofroni mbështetje afatgjatë për prindërit e trafikuar dhe fëmijët e tyre, të përshtatur me nevojat dhe situatat e tyre gjatë tre fazave të riintegrit (kriza, tranzicioni dhe riintegrimi/përfshirja). Kjo kërkon një vlerësim fillestar të nevojave të prindit dhe fëmijës, si dhe hartimin e një plani riintegrimi për prindin dhe fëmijën. Kryeni menaxhimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të rastit në planin afatgjatë. Shtyni kohëzgjatjen e riintegrit për rastet më komplekse dhe ato me nevoja më të ngutshme.

✓ **Kushtojini vëmendje rrezikut të krizave dhe pengesave të prindit dhe fëmijës.** Kini parasysh se prindërit e trafikuar dhe disa fëmijë viktime të trafikimit mund të përballen me kriza dhe pengesa që mund të pengojnë rikuperimin dhe riintegrimin e tyre. Sigurohuni që shërbimet dhe mbështetja të jenë të disponueshme në rastin e sfidave të krizës dhe që prindërit dhe fëmijët të dinë se mund të kërkojnë mbështetje në çdo fazë.

✓ **Sigurohuni që të gjitha vendimet janë në interesin më të lartë të fëmijës.** Gjithmonë merrni vendime që vendosin në interesin më të lartë të fëmijës. “Interesi më i lartë i fëmijës” duhet drejtë menjrën sesi kryhet vlerësimi i nevojave dhe sesi hartohet plani i riintegrit. Sigurohu që interesat më të larta të fëmijës të përfshihen duke balancuar faktorët kryesorë të lidhur me të drejtat konkurrese të fëmijës: këndveshtrimi i fëmijës, këndveshtrimi i anëtarëve të familjes dhe të afërmeve, siguria si prioritet, rëndësia e familjes dhe marrëdhënieve të ngushta, si dhe duke ushqyer nevojat për zhvillim të fëmijës.

Udhëzime për politikën dhe advokimin

✓ **Advokoni që fëmijët e viktimave të trafikimit si një kategori përfituesish të marrin mbështetje për riintegrim.** Fëmijët e viktimave të trafikimit kanë shumë nevoja për ndihmë dhe si të tillë, duhet të trajtohen si një kategori e veçantë përfituesish për të marrë mbështetje dhe shërbime riintegrimi. Profesionistët duhet të advokojnë që fëmijët e viktimave të trafikimit të njihen si një kategori e veçantë përfituesish, dhe gjithashtu është e rëndësishme që profesionistët dhe ata që bëjnë politikën të alokojnë fonde të mjaftueshme për të mbështetur rimëkëmbjen dhe riintegrimin e këtij grupi të cënueshëm të fëmijëve. Gjithashtu njihni ndërlidhjen e rezultateve të riintegrit për viktimat e trafikimit dhe fëmijët e tyre.

- ✓ **Alokoni burime për rintegrimim e fëmijëve të viktimave të trafikimit.** Për shkak se fëmijët e viktimave të trafikimit përgjithësisht nuk konsiderohen të trafikuar në vetvete, ata shpesh nuk përfitojnë mbështetje kundër-trafikimit nga shteti ose donatorët dypalësh. Është e nevojshme që burimet të vihen në dispozicion për rikuperimin dhe riintegrimim e të gjithë fëmijëve të viktimave të trafikimit. Advokoni me pushtetin lokal dhe qendror për të alokuar fonde të mjaftueshme për të mbështetur riintegrimim e të gjithë fëmijëve të viktimave të trafikimit.

Udhëzime për koordinimin dhe bashkëpunimin

- ✓ **Koordinoni dhe bashkëpunoni me sistemin e mbrojtjes së fëmijës.** Punoni dhe koordinohuni së bashku me organizatat për mbrojtjen e fëmijëve dhe ato anti-trafik për të mbështetur riintegrimim e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Referojini fëmijët e viktimave të trafikimit në sistemin e mbrojtjes së fëmijës, për të maksimizuar sa më shumë mbështetje dhe ekspertizë që të jetë e mundur përtej atyre të disponueshme në sistemin e mbrojtjes kundër trafikimit. Punoni së bashku me agjencitë dhe ekspertët e mbrojtjes së fëmijës në vlerësimin e nevojave dhe zhvillimin e një përgjigje të përshtatshme riintegrimim.
- ✓ **Mbani linja të hapura komunikimi.** Mbani linja të hapura komunikimi mes agjencive për mbrojtjen e fëmijëve dhe antitrafikimit. Informoni menjëherë agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve për çdo dyshim se fëmija po neglizhohet ose abuzohet nga prindi ose persona të tjerë me të cilët prindi shoqërohet ose anasjelltas.
- ✓ **Punoni në partneritet për të mbështetur fëmijët e viktimave të trafikimit.** Punoni me kolegët dhe mbikëqyrësit e organizatës, si dhe të organizatave dhe institucioneve për të zgjidhur problemet që lindin në riintegrimim e këtyre fëmijëve. Punoni së bashku për të kapërcyer kufizimet në mbështetjen efektive të sigurisë, mireqënies dhe riintegrimim afatgjatë të këtyre fëmijëve.
- ✓ **Ndërtoni një ekip multidisiplinar për të mbështetur fëmijët e viktimave të trafikimit.** Riintegrimim i sukseshëm nënkupton tejkalimin e problemeve dhe dobësive në nivelet e ndryshme dhe shfrytëzimin e burimeve të qëndrueshme dhe mbështetjes në jetën e viktimave dhe në mjedisin më të gjerë. Ndërtoni një ekip dhe rrjet multidisiplinar që mund të përdoret për të mbështetur rimëkëmbjen dhe rintegrimim e fëmijëve të viktimave të trafikimit.
- ✓ **Koordinoni dhe bashkëpunoni në nivel lokal.** Riintegrimim i viktimave dhe i fëmijëve të tyre merr fund përfundimisht në nivel lokal. Riintegrimim në shoqërinë formale dhe institucionet e saj përfshin sigurimin që viktimat e trafikimit të kenë akses në shërbime të disponueshme dhe të aksesueshme, veçanërisht në nivel lokal, aty ku viktimat e trafikimit riintegrohën. Bashkitë duhet të parashikojnë dhe të planifikojnë fonde për mbështetjen e fëmijëve të viktimave të

trafikimit dhe ta buxhetojnë atë. Stafi i shërbimeve sociale dhe agjencive për mbrojtjen e fëmijëve në bashki duhet të informohen dhe trajnohen në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe planifikimin e riintegrit.

Shtojcat

Shtojca #1. Fjalorthi i termave

Shtojca #2. Modele të praktikave të mira në punën me fëmijët e viktimave të trafikimit

Shtojca #3. Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS

Shtojca #1. Fjalorthi i termave

Termi	Përkufizimi
Asistencë	Masa vullnetare, programe dhe shërbime që synojnë rikuperimin e personave të trafikuar, të ofruara nga shteti, organizata jofitimprurëse (OJF), dhe organizata ndërkombëtare (IOs), në vendet e destinacionit, tranzitit dhe origjinës. Asistenca mund të jetë specifike për trafikimin ose në forma më të përgjithshme të asistencës, të ofruar si pjesë e shërbimeve shtetërore të përgjithshme, si sistemet e mbrojtjes së fëmijës ose shërbimet për personat e cenueshëm në aspektin social. Asistenca mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: akomodimin/strehimin, kujdesin mjekësor, asistencën psikologjike, arsimin, formimin profesional, aftësitë jetësore, punësimin dhe fuqizimin ekonomik, asistencën ligjore, transportin, dhe ndërmjetësimin/këshillimin familjar.
Qasje miqësore me fëmijën	Hartimi dhe zbatimi i masave duke pasur parasysh nevojat, interesat, sigurinë dhe interesat më të larta të fëmijës
Qasje e përshtatshme në aspektin kulturor	Marrja në konsideratë dhe respektimi i besimeve kulturore dhe fetare, vlerat, normat, praktikat dhe gjuhën e viktimës
Qasje me ndjeshmëri gjinore	Trajtimi i të gjitha viktimave me të njëjtin respekt, pavarësisht identitetit të tyre gjinor, duke shmangur stereotipet ose supozimet mbi baza gjinore
Identifikim	Identifikimi është procesi në të cilin individi identifikohet si viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme e trafikimit. Identifikimi formal është procesi ose vendimi që rezulton në një vendim shtetëror zyrtar se një person është viktimë e trafikimit, ndërsa identifikimi joformal është procesi ose vendimi që rezulton në faktin që një person konsiderohet viktimë e trafikimit jashtë procesit të identifikimit formal të shtetit.
Viktimë e prezumuar (ose e mundshme) e trafikimit	Personi që është konsideruar dhe identifikuar si viktimë e trafikimit, por që formalisht nuk është identifikuar si e tillë.
Mbrojtje	Një nga tre P-të (Protection) të përgjigjes kundër trafikimit, synon mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në përgjithësi, përfshin procesin e identifikimit, referimit, dhe asistencë, duke përfshirë riintegrimin. Gjithashtu, i referohet rolit të çdo qeverie për të ndërmarrë hapa afirmativë për të vlerësuar rreziqet dhe për të garantuar sigurinë e çdo viktime.

Riintegrim	Procesi i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai përfshin: sistemimin në një mjedis të sigurt dhe të siguruar; aksesin në një jetese standarde të arsyeshme; mirëqenien mendore dhe fizike; mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik; dhe aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale. Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e origjinës së viktimës, integrimin në një komunitet të ri, ose integrimin në një shtet të ri në varësi të nevojave dhe interesave specifike të individit. Riintegrimi ndodh në nivele të ndryshme: në nivel individual, në mjedisin familjar, në komunitetin e gjerë dhe në shoqërinë formale. ⁶²
Qasja e informuar mbi traumen	Njohja e ndikimit të traumës dhe promovimi i mjediseve të shërimit dhe rikuperimit
Qasja me në qendër viktimën	Prioritizimi i dëshirave, sigurisë dhe mirëqenies së viktimës në të gjitha çështjet dhe procedurat
Trafikim i personave (TiP)	Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose të një pozicioni të pambrojtur ose të dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi; shfrytëzimi do të përfshijë, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjes së organeve. ⁶³
Viktimë trafikimi (VT)	Personi që ka përjetuar dhe/ose përjeton sjellje të përcaktuara në nenin 3 të <i>Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (Protokolli i Trafikimit)</i> ose në legjislacionin përkatës vendas.

⁶² R. Surtees (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin, f. 11.

⁶³ Kombet e Bashkuara (2002) *Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*. Kombet e Bashkuara.

Shtojca #2. Modele të praktikave të mira në punën me fëmijët e viktimave të trafikimit

Shkolla verore (Qendra Ndërkombëtare për të Drejtat, Mbrojtjen dhe Promovimin e Grave, “La Strada”, Moldavi)

Qëllimi i shkollës verore për nënat dhe fëmijët ishte të ndihmonte nënat për të punuar mbi problemet e ngutshme që ato dhe fëmijët e tyre kanë përjetuar, dhe për të rivendosur apo krijuar marrëdhënie me fëmijët e tyre. Vendndodhja është një manastir, një mjedis i qetë, ku nënat dhe fëmijët e tyre do të ndihen të sigurtë, do të gjejnë paqe dhe do të ofrojnë kushte të përshtatshme jetese. Programi u zbatua nga një ekip profesionistësh (psikolog, psikolog-pedagog, punonjës social dhe kleri). Shumë nga temat e identifikuara si më të rëndësishmet për procesin e riintegrit të grave dhe fëmijëve ishin: marrëdhëniet ndërpersonale, vetëbesimi, vetëkuptimi, kontrolli, siguria, çlodhja dhe të menduarit pozitiv). Këto çështje janë trajtuar nëpërmjet teknikave dhe metodave të ndryshme, duke përfshirë teknikat e përballimit, ndërmjetësimin dhe kujdesin, si dhe forma të ndryshme të terapisë individuale dhe në grup.

Rezultatet kryesore nga shkolla verore ishin:

- Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet nënës dhe fëmijës;
- Zotësi për kontrollin e emocioneve negative dhe menaxhimin e stresit;
- Mbështetje emocionale dhe grupe mbështetëse;
- Angazhimi i strukturave fetare në procesin e riintegrit;
- Socializimi i fëmijëve.

Megjithëse shkolla verore shënoi disa suksese, nuk kishte kohë të mjaftueshme për të adresuar plotësisht nevojat e grave dhe të fëmijëve të tyre. Për rrjedhojë, kishte nevojë për të punuar me gratë dhe fëmijët e tyre pas kthimit të tyre në shtëpi, si dhe për t'i angazhuar në mjedisin e gjerë familjar që nuk ka qenë gjithmonë mbështetës. (puna me të afërmit agresivë);

Burimi: Budeci, A. (2006) “Rivendosja e marrëdhënieve ndërmjet grave (viktima të trafikimit) dhe fëmijëve të tyre” [‘Rebuilding relations between women (victims of trafficking) and their children’,] Te V. Rusu (Ed.), Praktikave të mira në sigurimin e asistencës së duhur për të gjitha kategoritë e personave të trafikuar. Libër burimor (f. 33–35). Moldavi: Qendra Ndërkombëtare për të Drejtat, Mbrojtjen dhe Promovimin e Grave, “La Strada”. E disponueshme në:

Modeli i praktikës së mirë: Shtëpia e Gjyshes (Të Ndryshëm & Të Barabartë, Shqipëri)

“Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër” është alternativë kujdesi nga profesionistë për fëmijët në një ambient që ngjan me shtëpinë në kohën kur prindërit janë në punë me orare të zgjatura ose punojnë të shtunave. Qëllimi është kujdesi për fëmijët dhe parandalimi i situatave sociale dhe të punësimit për nënat, të cilat mund të ndikojnë negativisht te rritja dhe zhvillimi i fëmijëve, dhe për t'i ndihmuar nënat që të luajnë plotësisht rolin e tyre në familje. Ky model është produkt i eksperiencës së profesionistëve: të kujdestarëve, edukatorëve, stafit të organizatës “Të Ndryshëm & të Barabartë”,

të cilët vazhdojnë me përkushtim dhe sakrificë të bëjnë më të mirën për fëmijët si edhe opinioneve dhe sugjerimeve të nënave, të cilat ua besuan fëmijët këtyre profesionistëve.

Shërbimet dhe mundësitë e ofruara në terren të “Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër” janë:

- Përkujdesja dhe mbikëqyrja nga një i rritur përgjegjës
- Higjiena dhe shëndeti
- Ushqimi dhe ushqyerja
- Mbështetja për shkollën/detyrat e shtëpisë
- Mbështetja emocionale dhe mësimi i sjelljeve pozitive sociale
- Lojërat për fëmijët
- Informimi i nënës dhe konsultimi me të lidhur me kujdesin për fëmijën
- Vëzhgimi i sjelljeve të fëmijës dhe raportimi i dyshimeve për neglizhim, abuzim apo ekspozim ndaj dhunës
- Vlerësimi dhe mbështetja psikologjike
- Vlerësimi dhe mbështetja mjekësore

Disa shërbime dhe mundësi janë ofruar në terren, duke përfshirë *vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e kujdesit, transportin në..., shëtitje në kohën e lirë, referim i nënës dhe fëmijës për vlerësim dhe trajtim të nevojshëm dhe mbështetja për prindërimin.*

Burimi: Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) Shtëpia e gjyshes ose shtëpia tjetër [Grandma's Home, My Other Home.] Tiranë, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Grandma%E2%80%99s-Home-or-My-Other-Home_book_english_ok.pdf

Shtojca #3: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *A fuller picture. Addressing assistance needs and vulnerabilities*. Oslo: Fafo& Washington: NEXUS Institute. Available at:
https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) 'Coming home. Challenges in family reintegration', *Qualitative Social Work*. Available at: <https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1473325011435257>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *No place like home? Challenges in family reintegration*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at:
https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf

Brunovskis, A. & R. Surtees (2008) 'Agency or illness. The conceptualization of trafficking victims' choices and behaviours in the assistance system', *Gender technology and development*. Available at:
<https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1177/097185240701200105?needAccess=true>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Leaving the past behind. When trafficking victims decline assistance*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at:
<https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2021) *Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi; Udhëzues për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manual për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2021/07/CASE-MANAGEMENT-MANUAL-DE_compressed.pdf

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Shtepia-e-gjyshes-ose-shtepia-tjeter_libri_shqip_Ok.pdf

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Studim mbi nevojat dhe mundësitë që ofron tregu i punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
<http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-tregun-e-punes/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Standardet e Shërbimit të Njësive Lëvizëse për Identifikimin dhe Referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
<http://differentandequal.org/sq/standardet-e-sherbimit-te-njesive-levizese-per-identifikimin-dhe-referimin-e-viktimave-viktimave-te-mundshme-te-trafikimit/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2015) *Të lënë pas dore! Trafikimi i burrave dhe djemve në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
<http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2018/12/Te-lene-pas-dore-1.pdf>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) *Studimi mbi Riintegrimin Social-Ekonomik të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
<http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-riintegrimin-social-ekonomik-te-viktimave-te-trafikimit-ne-shqiperi/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) Raporti Vjetor i organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:
<http://differentandequal.org/en/raporti-vjetor-2009/>

Surtees, R. (2019) ‘Feeling a failure: Returning home a ‘Trafficked man’ in Indonesia’, *openDemocracy*. Available at: <https://www.opendemocracy.net/en/beyond-trafficking-and-slavery/feeling-a-failure-returning-home-a-trafficked-man-in-indonesia/>

Surtees, R. (2018) ‘At home. Family reintegration of trafficked Indonesian males’, *Antitrafficking review*. No. 10. Available at:
www.antitraffickingreview.org/index.php/atrjournal/article/view/322

Surtees, R. (2017) ‘Being Home. Exploring Family Reintegration Among Trafficked Indonesian Domestic Workers’. In R. Piotrowicz, C. Rijken and B. Heide Uhl (Eds.) *Routledge Handbook on Human Trafficking*. Routledge. Available at: <https://www.routledge.com/RoutledgeHandbook-of->

[Human-Trafficking/Piotrowicz-Rijken-Uhl/p/book/9781138892064](https://www.humantrafficking.nl/book/9781138892064)

Surtees, R. (2017) *Moving on. Family & community reintegration among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/moving-on-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Our Lives. Vulnerability & resilience among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/our-lives-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Supporting the reintegration of trafficked persons. A Guidebook for the Greater Mekong Sub-Region*. Bangkok, Thailand: NEXUS Institute, UN-ACT and World Vision. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/04/final-reintegration-guidebook-gms.pdf>

Surtees, R. (2017) 'Declining assistance. Understanding trafficked persons' decisions, choices and resiliency'. In A. Aronwitz (Ed) *Human trafficking: A Reference Handbook*. ABC-CLIO. Available at: <https://www.amazon.com/Human-Trafficking-Reference-HandbookContemporary-ebook/dp/B01N9XAFJH>

Surtees, R. (2016) 'What's home? (Re)integrating children born of trafficking', *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2): 73-100. Available at: <https://www.tandfonline.com/eprint/Z5HzV2AZAZnqmxCyiBi4/full>

Surtees, R. (2015) *Beyond trafficking. The re/integration of trafficking victims in the Balkans, 2007 to 2014*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/06/beyond-trafficking-final-report.pdf>

Surtees, R. (2014) *Reintegration of trafficked persons. Trafficked children & youth*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/pub_3268_reintegrationoftraffickedchildren.pdf

Surtees, R. (2013) *Ethical principles in the reintegration of trafficked persons*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/02/ethical-principles-for-the-reintegrationof-trafficked-persons.pdf>

Surtees, R. (2013) *After trafficking. Experiences and challenges in the (re)integration of trafficked persons in the GMS*. Bangkok and Washington: UNIAP& NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/aftertrafficking_experiences-and-challenges-in-reintegration-in-the-gms.pdf

Surtees, R. (2012) *Reintegration of trafficked persons. Economic empowerment*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/nexus_economic-empowerment.pdf

Surtees, R. (2010) *Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/monitoring-at-reintegrationprogrammes_manual_nexus.pdf

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. Handling “difficult” cases*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-personshandling-difficult-cases.pdf>

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. How to be more effective*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-persons-howcan-our-work-be-more-effective.pdf>

Surtees, R. (2008) ‘Trafficked men and unwilling victims’, *St. Antony’s International Review*, 4(1), pp. 16-36. Available at: <https://www.ingentaconnect.com/content/stair/stair/2008/00000004/00000001/art00003>

Surtees, R. (2017) *Listening to victims: Experiences of identification, return and assistance in SE Europe*. Vienna: ICMPD & NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/listening-to-victims.pdf>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Identification: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Protection and Support: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Recovery and Reintegration of Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Special and Additional Measures for Child Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & F. de Kerchove (2014) ‘Who funds reintegration? Sustainable services for VoTs’, *AntiTrafficking Review*. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/whofunds-reintegration.pdf>

Surtees, R., Johnson, L.S., Zulfahary, T & S. DaengCaya (2016) *Going home. Challenges in the reintegration of trafficked persons in Indonesia*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/09/going-home-english-final.pdf>

Surtees, R. & S. Somach (2008) *Methods and models of mixing services for victims of domestic violence and trafficking in persons*. Washington D.C.: USAID, Creative Associates International, Inc., and the Aguirre Division of JBS International, Inc. and the NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2019/01/methods-and-modelsfor-mixing-services-for-victims-of-domestic-violence-and-trafficking-in-persons.pdf>